

949.65.088

K.9.5



MUSA KRAJA

**NJI HERE
KEMI THANE
JA VDEKJE
JA LIRI...**

949.65.088

K 95

25 VJET SHQIPËRI SOCIALISTE

MUSA KRAJA

NJI HERË KEMI THANË:

” Ja vdekje, ja liri ”

~~50711~~

22214

BIOTEKA E SHËTËRI

1987ET

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

EPOPEJA E LAVDISHME E VIGUT

Mirdita ishte krahinë e prapambetur, ndër më të prapambeturat e Veriut. Malësorët vuanin për bukë, vuanin për kripë. Në kullat e gurta sterrë të zeza, mblidheshin njerëzit kokë më kokë pranë vatrës së zjarrit dhe, nën dritën e tij, bisedonin, qanin hallet e tyre të shumta. Një postahë dhie, trungu, fieri dhe zjarri ishin shtresa, mbulesa dhe ngrohja më e mirë e mirditorit. Zakonet prapanike, paragjykimet fetare ua errësonin edhe më shumë jetën. Ndër 30 mijë banorë, vetëm tri shkolla fillore kishte Mirdita, duke përfshirë këtu edhe konviktin e Oroshit. Për institucione shëndetësore nuk bëhej fjalë fare. Sëmurej fëmija apo i riu, vdiste pa e ditur nga se, pa e parë njeri i mjekësisë. Varfëria e madhe e malësorëve, që jetonin në rripa toke të lehtë me pak krerë bagëti, rëndohej edhe nga kanunet e egra, në bazë të të cilave për një vadë uji vritej babai i fëmijëve, apo detyrohej të shërbente te «Kapidani i Mirditës». Burrat ishin të detyruar të zbatonin urdhërat e «Kapidan Gjonit» dhe një për shtëpi vihej nën

urdhërat e tij, me t'i çuar fjalë, pse «ja kishin borxh derës së Kapidanit» në bazë të kanunit. Kështu dera e Gjon Markajve mbante të ndrydhur, të përlur e të nënshtruar mirditorin; ajo shfrytëzonte djersën e malësorëve për të shtuar pasuritë e veta dhe shfrytëzonte gjakun e tyre që të mbetej vetë e «madhe», që të sundonte e vetme në tërë krahinën, e, bashkë me «krenët» e krahinave të tjera, me feudalët e me klikat reaksionare të regjimeve antipopullore, rëndonte mbi kurrizin e tërë Shqipërisë, madje, siç thuhej, mbante lidhje «me shtatë krajla», duke livadhisur në grazhdet e huaja për të njëjtin qëllim, që në çdo rrethanë të kishte mbështetje dhe të qëndronte si derë e parë. Përkrahej edhe nga feja e klerikët. Këta, për t'ja shtuar vlerën në sytë e naivëve dhe të të paditurve, thoshin: «Në derën e Papës së Romës asht shkruar emni i kësaj dera si një ndër ma besnikët e fesë katolike në botë».

Shtëpia e Gjon Markajve, dhe klerikët, që bashkëpunonin me të, pengonin përhapjen e çdo gjëje përparimtare në Mirditë. Dhe kur ndonjëri çonte krye e kundërshtonte «Kapidanin», në shtëpinë e Gjon Markajve kurdiseshin punët që të kriste pushka e mirditorit në trup të mirditorit. Dhe ndiqte gjaku gjakun, përhapej vëllavrasja, sundonte «Kapidani».

Me dinakëri të madhe përçante e sundonte Gjon Marku Mirditën. Prapambetjen e madhe arësimore e kulture të kësaj zone ai e përdorte duke forcuar kanunin e Lekë Dukagjinit, që i shërbente derës së tij. Në çdo kullë mirditore sundonte më plaku; të gjithë pjesëtarët e familjes së madhe pa-

triarkale i bindeshin atij. Një grup pleqsh, «pleqësia», drejtonte e zgjidhte punët e fshatit, ndërsa punët e gjithë Mirditës nëpër zona, «Kapidani» i zgjidhte me anë të pleqësisë, e cila, duke zbatuar kanunin e Lekë Dukagjinit, zgjidhte kontradiktat e shumta, që krijoheshin në fshatra e veçanërisht në mes të familjeve «të mëdha», duke siguruar njëkohësisht dhe besnikërinë e shërbimin ndaj derës së «Kapidanit».

Erdhi dita e zezë e 7 prillit. Çizmjja e rëndë e fashizmit i shtoi vuajtjet dhe mjerimet e popullit tonë, të malësorëve tanë. E porta e Gjon Markajve mbeti ashtu siç ishte, gjaksore, shfrytëzuese, përçarëse. Kështu, pas pushtimit fashist, për të cilin kishte punuar aq shumë Gjon Marka Gjoni, vëllavrasjet u shtuan edhe më shumë. Në vitin 1942 në Mirditë numërohen qindra vrasje për hasmëri.

Gjon Markajt u lidhën kokë e këmbë me fashizmin, duke u vënë krejt në shërbim të tij, aq sa njëri nga djemtë e kësaj dere, që kish mbaruar shkollën në Itali, u emërua zëvendësministër i punëve të brendshme.

Por kushtrimi i partisë për luftë të armatosur kundër shkelësve të huaj dhe tradhëtarëve të vendit u përhap edhe në Mirditë dhe lëkund i sundimin mizor të «derës së madhe».

Gjon Marka Gjoni nuk mund të pajtohej me përhapjen e lëvizjes nacionalçlirimtare edhe në krahinën që e quante të tijën. Ai donte ta kishte Mirditën si kështjellë të reaksionit, ku të mos shkelte këmbë partizani. Prandaj rekrutonte vazhdimisht milicë e xhandarë për t'i shërbyer pushtuesit e për ta pasur krahinën «të paprekur». E qëllimit të tij i shërbente me zell edhe kleri.

Por idetë e partisë kishin depërtuar edhe në ato skuta, që mbaheshin me qëllim në errësirën mesjetare. Fjalët e saj ndriçonin mendjet e mirditorëve. Krisi edhe pushka partizane, që paralajmëronte fundin e sundimit të «Kapidanit».

Ishte verë e vitit 1944. Operacioni armik i qershorit, sikurse ai i dimrit, kishte dështuar me turp, duke përfunduar me forcimin e gjithanshëm të forcave partizane, me ndezjen edhe më shumë të zjarrit të Luftës nacionalçlirimtare, me demoralizimin dhe shthurjen e përgjithshme të forcave reaksionare. Divizioni I po kalonte Shkumbinin në drejtim të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut. Forcat gjermane dhe bashkëpunëtorët e tyre vendas, duke parë se kishin të bënin me një mësymje të organizuar e të fuqishme të Ushtrisë nacionalçlirimtare, u alarmuan. Krerët e reaksionit të brendshëm, që mbaheshin në grazhdin e pushtuesit, të frikësuar deri në palcë, mblodhën forcat për t'i shkuar në ndihmë padronit të tyre. Kështu veprroi edhe Gjon Marka Gjoni, gjakpirësi më i madh i Mirditës, i cili ishte tmerruar, se ora e çlirimit po afrohej.

Në atë kohë, pjesa më e madhe e Batalionit partizan «Perlat Rexhepi» ndodhej në krahinën e Krasniqes, ndërsa disa njësi partizane të këtij batalioni vepronin në malësitë e Shkodrës, të Pukës dhe të Mirditës dhe goditnin pa pushim, ku mundnin, forcat armike, propagandonin e sqaronin popullin për gjendjen e krijuar dhe e mobilizonin në Luftën nacionalçlirimtare. Me këtë punë merreshin edhe Ndoc Mazi, Naim Gjylbegu, Ahmet Haxhia, Ndoc Deda dhe shokët e tjerë, që ishin hedhur në

luftë me armë në dorë kundër pushtuesit dhe veglave të tij, duke u inkuadruar në njesitet e Batalionit partizan «Perlat Rexhepi».

Në atë kohë ky batalion po vinte në zbatim udhëzimet që i kish dërguar shoku Enver Hoxha zëvendëskomisarit politik të këtij batalioni. Në këto udhëzime thuhej ndër të tjera:

«Të afrohet pjesa, që është kundër okupatorit. Të gjendet mënyra që simpatizantët e luftës, qoftë bashkë me çetën e bashkë me një shok të atij rajoni, qoftë pa çetë, të vihen në lëvizje fshat më fshat, mundësisht edhe jashtë krahinës, për të bërë propagandë për Frontin Nacional-Çlirimtar, për luftën, për Qeverinë Demokratike Popullore...

Në qoftë se në krahina, si Malësia e Madhe dhe Mirdita, nuk mund të hyni drejt për së drejti ushtarakisht ose si propagandistë, kërkoni lidhje miqësie ose njihuni me malësorët rrugës, kur vijnë në treg të Shkodrës, dhe lidhni me ta miqësi e foljuni për luftë, për shtypjen që i bëhet popullit, për të drejtat e popullit. Nëpërmjet këtyre elementëve do t'ju jetë e lehtë të futeni në katunde dhe në krahina... folni shumë për liri, për luftën tonë dhe mbushuni mendjen se kushdo që shtin në përdorim armët kundër atyre, që luftojnë gjermanët dhe tradhëtarët, është armik i popullit dhe, jo vetëm nuk duhet mbajtur vesh, por duhet luftuar. Studjoni shkaqet pse Kapidani i Mirditës e ka humbur influencën mbi një pjesë të popullit dhe kapeni më parë këtë pjesë dhe futuni në zemrën e saj nga kanalet që ka dalë vetë Kapidani»¹⁾.

1) Dokumenta të Shtabit të Përgjithshëm dhe të Komandës së Përgjithshme të Ushtrisë Nacional-Çlirimtare Shqiptare, pjesa I, faqe 280-281, Tiranë 1965.

Në Mirditë kishte qarkulluar në periudha të ndryshme, pothuaj në dy faza, një njësit partizan, i cili ishte përqëndruar kryesisht në zonën Gomsiqe-Dush-Pukë. Tani ishte faza e tretë dhe për të zbatuar udhëzimet e Shtabit të Përgjithshëm dhe të shokut Enver, shtabi i batalionit vendosi të dërgonte një njësit partizan në këtë krahinë, që të përhapte fjalën e partisë, të pengonte mobilizimin e mirditorëve milicë e xhandarë, t'i sqaronte ata e t'i ngrinte në luftë kundër Gjon Marka Gjonit dhe pushtuesit. Me njësitin prej rreth dhjetë vetash ishte edhe Ndoc Mazi, Naim Gjylbegu, Ahmet Haxhia, Ndoc Deda dhe Hydajet Lezha në ditët e fundit.

Këtij grupi i ngarkohej një detyrë e vështirë në një zonë, ku reaksioni ishte i fortë dhe që e quante si të pashkelur prej forcave partizane. Ishte një zonë, ku forcat tradhëtare mbanin lidhje të vazhdueshme me Gjon Marka Gjonin e vepronin verbërisht simbas urdhërave të tij. Por populli i Mirditës i deshi, i strehoi dhe i ushqeu djelmoshat për thjeshtësinë e tyre, për burrërinë dhe besnikërinë që i karakterizonte dhe më shumë për çështjen, së cilës i ishin kushtuar.

Duke bashkëpunuar ngushtë me Eardhok Bibën, me komunistë dhe me patriotë vendas nga Gomsiqa, Dushi, Mnela, të cilët bënin pjesë në këtë njësit apo bashkëpunonin me të, ky grup partizan e zgjeroi mjaft aktivitetin revolucionar dhe ndikimin në masën e popullit. Fjala e guximtarëve, fjala e partisë zinte vend në mendjen dhe zemrat e mirditorëve të vuajtur. Këta nisën t'i ndihmojnë më shumë partizanët trima e

t'i bëjnë shtëpitë e veta baza të sigurta për lëvizjen nacionalçlirimtare. Shumë fshatarë nuk pranonin të shërbenin si mercenarë, se e kuptuan që Gjon Marka Gjoni ishte krimineli më i madh i Mirditës, që familja e tij kishte shtypur e shfrytëzuar brez pas brezi banorët e asaj krahine dhe tani ndihmonte përdhunuesin e mëmëdheut, nazizmin gjerman, që po përgjakte me çizmen e tij të hekurt trupin e cfilitur të Shqipërisë.

Gomsiqja dhe fshati tjetër i afërt, Dushi, ishin bërë baza të rëndësishme për njësitet e Pukë-Mirditës. Ato ndikuan në shtrirjen e bazave të tjera në fshatrat e Mirditës, në Mnelë, Vig e më thellë.

Zgjerimi i lëvizjes nacionalçlirimtare e tërboi Gjon Marka Gjoni dhe tërë reaksionin në Mirditë. Klerikët nisën të vjellin më shumë vrer kundër forcave partizane dhe përkrahësve të tyre. Priftërinjtë e fshatrave flisnin njëmijë të zeza në kisha e jashtë tyre për komunizmin, duke përdorur dendur parullat e tyre se «komunistët marrin motrat për gra», se «duhet ruejt populli nga bolshevizmi», «prej lugatit të kuq» etj. etj.

Prifti i Gomsiqes, patër Pal Doda, përdori tërë ndikimin e tij fetar për t'i larguar fshatarët nga rruga e pjesëmarrjes dhe e përkrahjes së luftës për liri. Ai i vuri banorët e Gomsiqes që të betoheshin simbas kanunit poshtërues se nuk do të pranonin në shtëpitë e tyre asnjë partizan, se ndryshe «do t'i mallëkonte». Por ata nuk ja vinin veshin kërcënimeve të tij. Një nga pjesëtarët e njësitit partizan tregon:

«Kur hynim në shtëpi të fshatarëve gomsiqas, të zonjat e shtëpisë na thoshin:

— Kemi ba be mos me ju dhanë bukë as ujë as kurrja.

— Kush e ka ba benë? — i pyesnim ne.

— I zoti i shtëpisë.

— Atëhere na jepni bukë ju të tjerët; ai që ka ba benë të mos na sjellë asgja. — Dhe qeshnim të gjithë».

Fshatarët e Gomsiqes jo vetëm që i donin, i mbronin dhe i ndihmonin partizanët, por edhe vinin në lojë priftin, i cili përpiquej edhe t'i frikësonte, edhe t'i zhvatte. Rapsodi popullor pat qitë atëhere këngën, që këndohej mbrëmjeve, pranë zjarreve në shtëpitë e fshatarëve, atëhere kur grumbulloheshin njerëzit e shtëpisë e nën dritën e pishës bisedonin e këndonin me çifteli. Kjo këngë dëgjohet te fshatarët edhe sot e kësaj dite.

*Pater Pali, burrë me mend,
Afër kripes ka zanë vend,
Si tha meshë e sakramend,
Nisi frati me kuvend:
O të dashtunit katolikë,
Na ka ardhun një rrezik,
Ka shumë ditë që ma kanë thanë
Se ju mbrendë i keni lanë.
Ta besoni, të kshtent e mi,
Për kët punë kam hekun zi
Sa qe nisun një ushtri,
Jo ma pak veç plct tri mijë,
Në Gomsiqe për me hi,
Me ju djeg' me stan me shpi,
Mos me lanë njeri pa gri.
Por unë jam një zemërgjanë,*

U rashë miqve anë e mbanë,
 Ç'merr në Shkodër e Tiranë,
 E ushtrinë e kam ndalue,
 Prej rrezikut ju kam pështue;
 Unë për vedi gja nuk due,
 Por lipë meshë shejti Shna Ndue
 Për të mirat që ai ban.
 Pra në lter keni me lanë
 Jo ma pak se i napolon.
 Kush ma pak ka pare në shpi
 Të bjerë sqapin a nji dhi.

Gjon Marka Gjoni, që ishte në dijëni të suk-
 seseve të forcave partizane në përgjithësi dhe ve-
 çanërisht të Divizionit I, që po i afrohej krahinës,
 filloi të shqetësohej edhe më shumë, kur mësoi
 për aktivitetin e njësitit partizan në fshatrat e
 Mirditës dhe në malësinë e Lezhës. Ai çoi fjalë në
 të katër anët e Mirditës që të grumbulloheshin
 sa më shumë forca për të ruajtur kullat e tij,
 për të asgjësuar njësitin dhe për të zhdukur çdo
 rrezik, që i kanosej nga ardhja e partizanëve të
 tjerë. Atë e turbullonte sidomos mendimi që kish
 populli se komunistët vdesin për çeshtjen që kanë
 nisur, se ata nuk dorëzohen të gjallë etj. I tër-
 buar nga sukseset partizane, hapi qeset e tija, ku
 kish kulluar djersa dhe gjaku i mirditorit, që të
 joshte kriminelët, të cilët ishin gati të vrisnin
 vëllezërit e tyre. Kështu ai krijoi çeta ndjekëse me
 mercenarë, që i paguante me nga 1500 franga në
 muaj, dhe i furnizonte me armë e ushqime. Në krye
 të çetave ndjekëse vuri kriminelët Pjetër Lleshi,
 Gjon Dodani etj. I alarmuar, porositi krerët e re-



Pesë heronjtë e Vigut (pikturë)

aksionit që t'u ngrinin pritë mbas prite partizanëve deri sa t'i asgjësonin, por njësitë vazhdonte punën e tij. Për arësye manovrimi, për t'u shpëtuar ndjekjeve të forcave të Gjon Marka Gjonit dhe pritave të tyre, njësitë vepronte herë në grupe dhe herë i bashkuar.

Mbasi kishte kryer misionin e tij, njësitë mori urdhër që të kthehej në fshatrat e Shkodrës për të marrë pjesë në formimin e një reparti të ri partizan në këtë zonë. Ashtu siç e kishin lënë në mbledhjen e fundit që kishin bërë në korrik në pyllin e Ungrejve, shokët u nisën nga malësia e Lezhës për në Rrasë të Butë dhe prej andej në Gazhnjet, në Vig dhe pastaj, gjithnjë duke u bashkuar me shokë të tjerë, simbas pikave të takimit që kishin lënë, do të grumbulloheshin dhe të bashkuar do të kalonin në drejtim të shpatit të Mnelës, në Gomsiqe, në Vjerdhë dhe me trap do të hidheshin përtej Drinit e do t'i afroheshin Shkodrës, ku do të formohej «Grupi partizan territorial i qarkut të Shkodrës».

Kur kaluan qafën, që të qet në zall të Vigut, në Buzabardh, luginë e gjerë plot zall e shkurre, përmes së cilës kalon lumi Gjader, partizanët hetuan forca bashibozuke të grumbulluara. Njësitë vazhdoi rrugën, duke ju shmangur pak drejtimin për të mos rënë mes përmes tyre. Kur çeta e vogël ecte bregores, partizanët e kuptuan se kishin rënë në pritë.

Kryetari i komunës së Kalivaçit, agjenti i Gjon Marka Gjonit, Pjetër Lleshi, i cili ishte edhe komandant i bashibozukëve e njëkohësisht drejtonte pritën, që me aq kujdes e kishte përgatitur që në të zbardhur të ditës, thirri:

— Ranë, bre.

Partizanët nuk e ndalën hapin dhe vazhduan rrugën që kishin marrë. Por në atë çast dëgjuan thirrje:

— Ndal, Ndal! Kush jeni? Kah shkoni?

— Jemi shqiptarë, kemi dalë maleve për liri, — u përgjegjën.

— Ndaluni, bre, dhe dorëzoni armët. Jeni të rrethuem. Pa dorëzue armët nuk delni të gjallë këndeje.

Partizanët u ndalën me pushkë e bomba në duar e të gatshëm për luftim. Shpejt ranë barkas në pozicion luftimi.

— Çka kërkoni prej nesh? — pyeti Ndoc Deda, i shtrirë barkas ashtu si edhe shokët e tjerë.

— Dorëzohuni, — u dëgjua një zë sikur vinte nga dheu. Kjo kërkesë u bë edhe nga katër a pesë zëra të tjerë.

— Jemi partizanë, s'asht zakoni ynë me u dorëzue, — thirri Ndoc Mazi.

— Na e thirrni të parin tuej, se duem me u marrë vesht para se me ja nisë pushkës, — tha Naimi e deshi të çohej në këmbë.

Por Pjetër Lleshi, i siguruar mirë në pozicion, nuk donte të dilte ballë për ballë me burrat. Ashtu i strukur, siç ishte, i shoqëruar nga disa dhjetëra bashibozukë aty krejt afër tij, të gatshëm për të hapur zjarr, thirri:

— Ndal, mos luej, dorëzohuni!

Naimi, duke e parë se prita kishte frikë të nxirrte njerëz ballë për ballë, shtrëngoi pushkën, liroi me të shpejtë bombat nga rrypi dhe u bë gati për luftim. Në çast, Ndoc Deda u çua nga pozicioni

me pushkë në dorë e u drejtua nga prita, me qëllim që të ndeshej me kryetarin e bashibozukëve.

— Armët duem, o Ndoc Deda, — i thirrën nga prita. — Këndeje mos u afro, por hidhe pushkën për-tokë. Lëshoni armët, se jetën e keni të falun.

Kështu as Ndocin s'e lanë me ba hap përpara. Atëherë Ahmet Haxhia, i cili fliste qartë dhe rrjedhshëm, nisi të demaskonte krerët e tradhëtisë:

— Gjon Marka Gjoni e shërbëtorët e tij Pjetër Lleshi, Preng Ndou, Marka Jak Bajraktari e Gjon Dodani me shokë nuk kanë asgja të për-bashkët me Mirditën. Mirditorët janë vëllaznit tonë, kurse ata janë sahanlëpirësit e italianit e të gjermanit; ata nuk kanë asgja prej shqiptari. Kemi dalë në këto anë për popullin e Mirditës dhe të gjithë Shqipnisë. Duem me u bashkue me vllaznit tonë mirditas që ta çlirojmë Mirditën dhe Shqipninë nga okupatori gjerman dhe shërbëtorët e tij. Këto armë i kemi ngjeshë për të luftue tradhëtarët e Mirditës; me ato jemi gati me u vra.

— Shumë nga ju, — thirri njëri nga partizanët, — jeni të rrejtun. Ju kanë shti me vra vllau vllanë. Kthejani pushkët tradhëtarëve!.

Dhe partizanët vazhduan të demaskonin emër për emër kriminelët me damkë, që ishin vënë në shërbim të pushtuesit. Patë pështjellim midis atyre që kishin zënë pritë. Disa nuk e zgjatën më, por me pushkë në dorë u larguan në drejtim të fshatit, të tjerë u lëkundën, bisedonin njëri me tjetrin. Pjetër Lleshi u egërsua si bishë, ju kërcënua atyre që u larguan se do t'i pushkatonte, do t'i varte, bërtiste: «ktheuni, he qena!», por ata që kishin lënë pritën nuk u kthyenë kështu që «qena» mbe-

tën ata që nuk lëvizën nga prita. Rrethimi vazhonte. Komandantët e bashibozukëve kishin shpërndarë 200 e sa pushkatarë në pozicione të atilla, nga ku nuk dilej i gjallë prej rrethimit. Këtë e kuptonin mirë partizanët, prandaj, pa lëvizur nga pozicioni i luftimit, vazhdonin të demaskonin Gjon Marka Gjonin me shokë. Mercenarët u premtorin se do t'u falnin jetën, veç armët t'i dorëzonin. Por armët s'i lëshonin partizanët nga dora pa u çliruar e gjithë Shqipëria. Dhe këtë nuk e kish kuptuar ende Pjetër Lleshi me shokët e tij, i cili ishte shumë i dëshiruar që t'ja çonte partizanët të gjallë «Kapidanit», i cili do t'i turpëronte në të gjithë Mirditën, që të diskreditonte para popullit lëvizjen nacionalçlirimtare.

Krerët e bashibozukëve shpresonin se partizanët do të dorëzoheshin të gjallë, e kështu do të plotësohej kërkesa e Kapidan Gjonit, do të fitohejshin pare e grada. Prandaj edhe nuk jepej urdhëri që të hapej zjarr kundër fatosave partizanë. Por trimat përgjigjeshin se nuk ishin cuba si ata, se armët i kishin marrë për të luftuar tradhëtarët, për të çliruar vendin dhe jo për t'ua dorëzuar sahanëlëpirësve.

Gruaja trimëreshë, mirditorja Drande Marka Jaku mbasi u përpoq më kot ta bindte pritën që të hiqte rrethimin, duke i lënë djemtë të lirë në rrugën që kishin nisur, me gjithë kërcënimet e bashibozukëve, ju afrua partizanëve për t'u dhënë ujë.

Të zhuritur nga vapa e madhe, në mes të gurëve të zallit të Gjadrit, në atë ditë të nxehtë gushti, trimat pinë ujë, pastaj zhdukën dokumentat,

u falën me gruan dhe i dorëzuan një letër për komitetin qarkor të partisë në Shkodër. Se çfarë ka parë në çastin e takimit me partizanët, gruaja trimëshë ka treguar:

«Njerëzit e Kapidan Gjonit kishin rrethue gjithë Buzabardhin. Partizanët ishin rrethue keq. Për pa vdekë, nuk kishin rrugëdalje. I kam ndigjue zanet e pritës, që u drejtoheshin partizanëve për t'u dorëzue, mbasi shpresonin se do të thyheshin. Nji za u përgjegj: «Partizanët për së gjalli armët nuk i dorëzojnë». Ishte zani i Ndoc Dedës. Në radhët e armiëve ka pasë përziemje, rrëmujë. Ndoc Deda qëndronte në kambë. Njeni me flokë të zez kaçurela ishte ulë në gjunjë afër Ndocit dhe shtrëngonte në dorë një bombë dore më duket se ishte Naimi. Nji tjetër, hollak (Ndoc Mazi) shikonte rreptë nga prita. Dy të tjerët rrinin me pushkë në faqe. Kishin ardhë edhe bajraktari i Kashnjetit, Jak Firoku, e kryetari komunës, Pjetër Lleshi. — A ndigjoni, more komunist, — bërtiti njeni, — erdhi urdhni prej vetë Kapidan Gjonit ose me i dorëzue armët o të gjallë prej këtu nuk delni.

— U mbusha tri herë tasin me ujë. Partizanët kërkonin me më falë plaçkat e veta, me jau çue fëmijëve. Mue s'më bante zemra me i marrë».

Letra që shkruan heronjtë ishte një letër pre-këse, plot optimizëm e besim se Lufta e drejtë nacionalçlirimtare do të kurorëzohej me fitore, se

pushtuesit e tradhëtarët do të mundeshin, se populli do të merrte pushtetin në duart e tij. Megjithëse e prisnin vdekjen nga çasti në çast, ata qëndronin lart moralisht, nuk pendoheshin që flijonin jetën për idealet e tyre të larta, për lirinë e atdheut.

Ja kjo letër mallëngjenjëse dhe optimiste:

«Të dashtun shokë,

Jemi të rrethuem dhe presim në çdo minutë të na përshkojnë plumbat e tradhëtarëve; por na kemi da ma mirë me dhanë jetën si me le, se sa me tradhëtue luftën që kemi nisë. Nji herë kemi thanë: «Ja vdekje, ja liri». Pra, o shokë, ju do të ndjekni punën tonë, prej ku po e lamë na me guxim të pathyeshëm.

Shokë, prej maleve të Mirditës... ju çojmë përshëndetjen tonë, tue brohoritë të gjithë një zani:

— Vdekje fashizmit! Liri popullit!

— Vdekje okupatorit barbar që na ka shnderue vatanin!

— Vdekje tradhëtarëve si Gjon Marka Gjoni, Mustafa Kruja, Kolë Biba etj.

— Rroftë Partia Komuniste Shqiptare!

— Rroftë Këshilli i Përgjithshëm Nacional-Çlirimtar!

— Rroftë Rinia Komuniste Shqiptare,

që po jep heroj përçlirimin e vatanit prej
tradhëtarëve dhe okupatorit.

— Rroftë Ushtria nacionalçlirimtare.
Të fala shokëve

(pesë shokë)

Teli, Besniku, Tigri, Minuku, Hydaj.»

Vig 21.VIII.1944.

Gruaja mirditore, me zemër të lënduar, me
lot ndër sy, u fal edhe një herë me trimat dhe u
largua mbasi e kish siguruar amanetin e tyre.

Prita më kot priste që të dorëzoheshin të rre-
thuarit. Orët kalonin. Bashibozukët habiteshin me
qëndrimin e patundur të partizanëve, të cilët edhe
pse kishin mundësi që të shpëtonin po të dorëzo-
heshin, edhe pse e kishin vdekjen të sigurt, nuk i
trembeshin aspak asaj.

Filloi kënga partizane! e filloi njëri dhe e
shoqëruan të tjerët. Ishte një këngë që dilte nga
gjokset rinore, nga thellësia e pesë zemrave tri-
moshe. Kjo këngë i habiti, i tmerrroi armiqtë. Dhe
pushka krisi, ishte pushka e tradhëtisë së zemë-
ruar, që humbi shpërblimet. Ajo u pasua nga një
bombë që trimat i hodhën pritës. Ushtoi Vigu. Tra-
dhëtarët habiteshin. Me çfarë brumi njerëzish ki-
shin të bënin! Kjo i tmerronte edhe më shumë;
ishte brumë i veçantë. Mbi 200 gryka pushkësh
drejtoheshin në trupat e partizanëve, të cilët me
pushkë e bomba, me thirrje për lavdinë e Partisë,
të Atdheut, të Popullit, i përgjigjeshin zjarrit me
zjarr.

Pjetër Lleshi, që kishte menduar «me i lidhë të pesë për laku, me i rrafë m'i farë dajaku» dhe «me ja çue gjallë Kapidanit», kishte mbetur si i ngrirë e herë-herë çirrej e bërtiste që të qëllonin sa më shumë. Por partizanët s'jepeshin. Ata sapo ishin betuar «me dhanë jetën si me le» dhe vazhdonin të qëndronin si heronj. Gjashtë orë të tëra pesë fatosat përballuan rrethimin me furinë e dyqind e ca pushkëve bashibozuke derisa lanë me gjakun e tyre të pastër Buzabardhin. Atëherë cubat e Marka Gjonit, të prirë prej kryetarit të komunes, u sulën për të grabitur trimat e rënë.

Mirdita mësoi lajmin e hidhur; atë humbje e ndjeu i madh e i vogël, tek të cilët u shtua edhe më shumë urrejtja për cubat kriminelë, për kryetarin e tyre Gjon Marka Gjonin. Bij të Mirditës u bashkuan me partizanët. Lëvizja nacionalçlirimtare në këtë krahinë mori përpjesëtime më të mëdha. Rap-sodi popullor mirditas, në ato ditë këndonte:

*«Dit' e hanë n'gjasht' sahati,
Pjetër Lleshi, shpirtxhelati,
Thotë xhandarvet: bahi gati,
Bini fushës për së gjati,
E në Vig ju, kur të shkoni,
Zini prita n'at breg prroni,
At'herë shkojn' xhandart ke boka,
Me ta shkon Ded Marka Gjoka,
Si ma t'poshtë se ka toka.
Bash në vendin e caktue
Anemban' prita kan vue
«Hidhni armët me të letë,
Mos m'i prekë ma për këtë jetë».*

Ndoc Miloti i vikati:
«Nuk na merrni t'gjall për laku,
Der në gju të bahet gjaku.
Gjallë me marre na nuk jesim,
Mirë e dimë se për çka vdesim.
Komunistat i ngef bota,
Nuk na trembin pushka e topa,
Na për popull bahna copa.»
Kështu ka folë Ahmet Haxhia:
«Rroftë partia dhe Shqipnia,
Gjallë s'i lshoj armët e mia»
Çka po thotë Naim Gjylbegu:
Del kryetar n'at fushë bejleku,
Mos u struk mbas atij bregu,
Delni sheshit, ore cuba,
Mos u mshifni ndër kaçuba,
N'ato brigje edhe curra,
Delni n'shesh, vriti me burra.»
Flet Ndoc Mazi, ai far' trimi:
«Keni luftë me komunista
E me krejt popullin shqiptar,
Me puntor' e katundarë.
Le t'vej gjaku sikur ujë,
Gjallë ne armët s'i dorëzojmë kuej,
Në Shqipni nuk lamë të huej.
Edhe ju, more tradhëtarë,
Ju shkelmon populli shqiptar,
Krejt në plumb e në litar,
Nuk ju len asnjë për farë.»
Hidajeti, trimi djalë,
Po ju flet kadalë-kadalë:
«Kriminela e budallë,
Merrnje vesht këtu një fjalë,
Tash një muej në mal kam dalë,

*S'i lshoj armët për të gjallë,
Pa m'ra plumbi mu në ballë.
Partizanët, të gjithë e dinë,
Vullnetarë e lanë shtëpinë,
Se me gjak çlirojn Shqipninë.»*

Rënja heroike e pesë partizanëve në Vig që një humbje e rëndë për popullin e Shkodrës, për qarkorin e partisë, por me këtë akt të bijve të saj Partia Komuniste Shqiptare i tregoi popullit të Mirditës dhe të gjithë vendit se për komunistët më e shenja gjë është çlirimi i vendit, pavarësia dhe liria e plotë e tij. Partizanët e atij njësiti i treguan popullit të Vigut, Kashnjetit, Mnelës, krejt asaj krahine, se e vetmja përgjegje për Gjon Marka Gjonin, Pjetër Lleshin etj., ishte plumbi i pushkës.

Ato ditë, në lidhje me epopenë e Vigut, trakti i komitetit qarkor të PKSH për Shkodrën shkruante:

«Nësa në katër anët e Shqipnisë buçet lufta që bajnë kundër okupatorit nazist dhe tradhëtarëve korparmatat, divizionet e brigadat e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, në kaq edhe numri i martirëve të lirisë, i dëshmorëve të ramë për Atdhe e popull po shtohet dita-ditës. Pllambë për pllambë kjo tokë kreshnikësh po vadihet me gjakun e djemve të saj ma të mirë. Gjaku i pesë dëshmorëve të lirisë, i pesë partizanëve të tjerë e skuqi edhe një herë tokën e qarkut tonë, u bashkue me gjakun e të tjerë dëshmorë-



Shoku Enver Hoxha me prindër dëshmorësh. Përpara, në të djathtë e në të majtë të shokut Enver nënat e Ndoc Mazit dhe Naim Gjylbegut.


ve për ta provue se populli shqiptar e meriton lirinë, të cilën po e fiton me gjak...»

Trakti përfundonte:

«Pushoni të qetë, o shokë të luftës, dhe të jeni të sigurt se gjaku juej dhe i të gjithë dëshmorëve të tjerë do të shpaguhet mbi kokat e nazistëve okupatorë e të tradhëtarëve me dhjetë për një».

Divizioni i parë, që marshonte përpara në Veri, për çlirim të vendit, simbas urdhërit që kishte marrë nga komandanti i përgjithshëm, shoku Enver Hoxha, çliroi edhe Mirditën. Kullave të familjes së Gjon Markajve, në të cilat për shekuj ishin kurdisur kurthe të shumëllojshme e vëllavrasje për popullin e Mirditës forcat e Divizionit I, të ndihmuar aktivisht nga masa e popullit të krahinës, u vunë zjarrin e bënë shkrumb e hi gjithshka i përkiste Gjon Markajve.

«Kullat e Gjon Marka Gjonit që nuk i kish djegur as Sulltani, as Italia, as Gjermania, — tha shoku Enver Hoxha para popullit të Mirditës, në vitin 1949, — ato që ishin bërë fortesë e lyer me gjakun e popullit i shkatërroi ushtria e popullit, djemtë e popullit fukara, djemtë e popullit të vuajtur, djemtë tuaj. Ato kulla përfaqësonin për popullin e Mirditës mjerimin e madh, tmerret që kish hequr populli nga ajo familje».



Në përvjetorin e parë të epopesë së Vigut eshtrat e tre heronjve, bij të Shkodrës, sillen në qytet;


Më 21 gusht të çdo viti, me mijëra të rinj dhe të reja nga Shkodra, nga gjigandi energjetik i Vaut të Dejës, nga fshatrat përreth, kalojnë nga Mnela gjatë rrjedhjes së lumit Gjadër dhe grumbullohen në Vig, afër shkollës së fshatit në Buzabardh, ku ngrihet lapidari i pesë heronjve. Këta të rinj bashkohen me qindra e qindra të tjerë, që vijnë nga Zadrima, thellë nga Mirdita, nga Lezha, malësia e saj si dhe nga Puka. Të gjithë së bashku dëgjojnë t'u flasin pranë zjarreve partizane shokë të Ndoc Mazit, Naim Gjylbegut, Ahmet Haxhisë, Ndoc Dedës, Hidajet Lezhës. Dikush ndalet dhe tregon aktivitetin e gjatë revolucionar të Ndoc Mazit, të cilin s'e ndaloj sëmundja e rëndë për t'u hedhur aktivisht në luftën e ashpër për çlirimin e vendit, të tjerë mbi papërkulshmërinë e Naimit përpara torturave të xhelatëve, mbi trimëritë e tij si komandant çete, mbi formimin si revolucionar të Ahmet Haxhisë, mbi punën e madhe që bënte ai me popullin e veçanërisht me rininë, mbi aktivitetin e Ndoc Dedës në ushtrinë e vjetër «kombëtare» për dezertimin e ushtarëve, sabotimin e armatimit, mbi trimëritë e treguara në batalion, si dhe mbi vendosmërinë e Hydajetit, djaloshit jetim, që gjeti gjithshka në gjirin e partisë; ata flasin mbi transformimet e mëdha dhe perspektivat e shkëlqyera të krahinës dhe të gjithë vendit.

Mbi epopenë e lavdishme, me të cilën u mësuara dhe do të mësohet brez mbas brezi rinia, për të vënë çeshtjen e popullit, të partisë mbi gjithshka, u flet Buzabardhi i vaditur me gjak të pastër, të kuq, u flet Vigu.

NDOC MAZI
(MINUKU)

*Le të vejë gjaku sikur ujë,
Gjallë ne arm't s'i dorëzojmë kuej...*

Në lagjet, ku ishte përqëndruar baza më e fuqishme materiale e klerit katolik në Shkodër, ku brenda përbrenda qytetit ishte krijuar një qytet i vogël me kisha e shkolla klerikale, me lloj-lloj institucionesh ideologjike, kulturele, sportive etj., të cilat i shërbenin propagandimit të ideologjisë fetare, ideologji e klasave në fuqi dhe sidomos e të huajve, gjendeshin shumë familje të varfëra shkodrane, të cilat me zor nxirrnin bukën e ditës. Në njërin prej tyre, në një shtëpi përdhese, banohte punëtori i varfër Kol Mazi me të shoqen e tij Ninën, të cilëve në ditën e dymbëdhjetë të nëntorit të vitit 1920 u lindi një fëmijë. Ishte vogëlushi që edhe në moshën madhore do të mbetej i pakët nga trupi, po që edhe pse ishte i imët fizikisht, kishte fuqi kolosi e do të ngrihej bashkë me moshatarët e tij për të përmbysur pushtue-



Ndoc Mazi

sit dhe veglat e tyre që pushteti të ishte i punëtorëve e i fshatarëve, i popullit të shumëvuajtur.

Kishat dhe xhamitë me priftërinjtë e hoxhallarët e tyre i dukeshin djaloshit sikur i rëndonin mbi kurriz. E, megjithatë, ato nuk ja zbehnin karakterin e tij të gëzuar dhe optimizmin rinor, sepse për Ndocin Shkodra, qyteti i tij i dashur, vendi i lindjes, ishte qyteti i njerëzve të punës, i luftave të përgjakshme për shqiptarizmin, i patriotëve dhe shkrimtarëve të flakët, i këngëve të bukura, i luleve shumëngjyrëshe, i humorit, i besës dhe i burrërisë, ashtu siç ishte gjithë Shqipëria. E ishin këto cilësi që i linin mbresa, që ndikuan drejt për së drejti në formimin e këtij vogëlushi.

Rritej djaloshi, duke shkuar çdo ditë me një çantë pëlhere në qafë, në drejtim të shkollës. E donte Ndoci shkollën. Dhe mësuesit shikonin tek ai nxënësin e rregullt, të zgjuar dhe me humor, aq sa, edhe në mes të mësimit, shpesh plaste një e qeshur e këndshme në të gjithë klasën e krijohej një ambient i gëzueshëm shoqëror si rrallë në ndonjë klasë tjetër. E përpara natyrës së tij të gëzueshme dhe humorit të këndshëm tërhiqeshin edhe mësuesit «e rreptë», që përpiqeshin t'i përmbahehin zyrtarizmit dhe shkollarizmit të tyre të theksuar.

Në vatrën revolucionare të qytetit, në gjimnazin e Shkodrës, ku mësonte edhe Ndoci, ishin grumbulluar djem të shtresave të ndryshme, në mes të të cilëve kishte edhe prej atyre, që do të bëheshin bij të lavdishëm të Atdheut dhe të Partisë Komuniste. Nga diskutimet njëri me tjetrin, nga leximet e veprave të shkrimtarëve përparim-

tarë, si e ndonjë vepre të Gorkit, të ndonjë shkrimi që botonte në revistën e Korçës Migjeni, apo të ndonjë dorëshkrimi të tij etj., sidomos nga jeta e padurueshme që i rrethonte, të rinjve u shtohesh ndjenja e revoltës, dëshira për të krijuar një botë të re, ashtu siç e kishin krijuar punëtorët e fshatarët në Bashkimin Sovjetik nën udhëheqjen e Leninit dhe të Stalinit.

Ndoci mësonte mirë, i ndihmonte shokët dhe gjendej gjithnjë pranë tyre. Humori i tij i hollë, nga i cili krijohesh një ambient gazmor për të gjithë të pranishmit, ishte theks për klasat në fuqi dhe përkrahësit e simpatizantët e tyre. Anekdotat që tregonte zakonisht, i sajonte vetë dhe, siç dëshmojnë shokët e tij, nuk ishin anekdota për anekdota, po me përmbajtje, me një kuptim, me thumba për regjimin feudalo-borgjez dhe klerin, që i shërbente atij.

Sinqeriteti, mprehtësia, bujaria, thjeshtësia dhe ngrohtësia ndaj shokëve e bënë atë të njohur në të gjithë shkollën. Me Qemal Stafën e shihesh shpesh, duke përcjellur njëri-tjetrin edhe pse shtëpitë i kishin në drejtime të ndryshme. Ndoci shquesh për pjesëmarrje aktive në jetën shoqërore të shkollës.

Në rrugën e revolucionit

Në vitin 1938-1939, kur një pjesë e mirë e nxënësve të gjimnazit të shtetit ishin përfshirë në veprimtari revolucionare, Ndoci e kishte shtuar shumë aktivitetin e tij, duke qenë i lidhur me



Ndoc Mazi në Shkodër

shokët e grupit komunist të Shkodrës, ishte pranuar anëtar i grupit dhe mbante anën e shokëve aktivë, që bënë krahun e shëndoshë të atij grupi. Me Qemal Stafën e pat thelluar shumë shoqërinë, aq sa vjersha «Kumbanorja» e Qemalit e ka burimin e frymëzimit në familjen e Ndocit. Si mo-shatarë, nxënës në gjimnaz, anëtarë të grupit komunist, ata shpeshherë bisedonin shtruar për organizimin e luftës kundër feudo-borgjezisë.

Qeveria reaksionare e Zogut mundi të zbulojë dhe të arrestojë pjesën më të madhe të anëtarëve të Grupit komunist të Shkodrës. E, bashkë me Qemal Stafën e Vasil Shanton, në burg u ndodh edhe Ndoc Mazi. Kështu, ditët e ftohta të janarit të vitit 1939 Ndocin e gjetën nën shkallët e prefekturës në Shkodër. Atje njohu torturat e egra që i bënin për ta detyruar që të fliste. Por ai nuk ndoqi shembullin e krerëve të grupit, të tradhëtarëve Zef Mala e Niko Xoxi, të cilët treguan shokët e grupit dhe veprimtarinë e tij, po të Qemalit dhe Vasilit. Për ta detyruar që të hapte gojën, Ndocin e qëlluan me shkopinë në shojet e këmbëve; hidhnin ujë në çemento dhe e detyronin të ecte zbathur; qarkomandanti dhe xhelatë të tjerë e shtrinin për tokë në çemento, dhe ashtu siç ishte i lidhur, e qëllonin pareshtur. Një shok tregon se Ndocin e kishin futur në një dhomë më vete për ta torturuar me një llambë me voltazh të lartë, të cilën ja lëshonin në fytyrën e lodhur nga pagjumësia për të mos fjetur; ashtu, të lidhur siç ishte, e thernin nga prapa me majë bajonete. Por Ndoci u qëndroi burrërisht torturave.

Nga Shkodra e dërguan në burgun e xhandarmërisë në Tiranë. Atje u takua përsëri me Qemalin, Vasilin dhe shokë të tjerë aktivistë të grupeve komuniste. Edhe atje provoi tortura nga më të egrat: e qëllonin me thupra, i futnin spica në majat e gishtërinjve, i vinin në mes të gishtërinjve të dorës shkopinj, duke i mbledhur pastaj gishtat, për t'i shkaktuar një dhëmbje të padurueshme. Mbasi hetuesia dështoi në përpjekjet e saja për ta detyruar që të fliste rreth aktiviteteve të veta dhe të shokëve, e dërguan në burgun e madh të Tiranës, nga ku, mbas disa ditësh, e hodhën së bashku me shokët e tjerë në gjyq. Tek ecte rrugës për në gjyq, Ndoci gëzohej kur shikonte qytetarët që shprehnin simpatinë për të burgosurit politikë dhe protestën kundër regjimit feudalo-borgjez të Zogut. Në sallën e gjyqit kishte shumë agjentë, njerëz besnikë të regjimit shtypës. Po komunistët e vërtetë, me guximin që i karakterizonte, u hoqën maskat armiqve të popullit dhe të atdheut, satrapit Zog dhe klikës së tij, duke ua thënë hapur se po shitnin Shqipërinë te Italia fashiste, se po luanin me fatin e atdheut, me ndjenjat e popullit tonë. Gjyqi u bë vendi, ku Qemal Stafa, Vasil Shantoja dhe shokë të tjerë i bënë një aktakuzë të rreptë regjimit të Zogut, u bë vendi ku Qemali, Vasili e Ndoci dhe shokë të tjerë mbrojtën me kokën lart interesat e popullit, të Shqipërisë, të komunizmit. Atje Ndoci dha edhe një herë provën e besnikërisë së tij ndaj shokëve dhe çështjes së madhe, të cilës i ishte kushtuar. Prandaj u dënua me burgim dhe u dërgua së bashku me shokë të tjerë në Mbretërinë e Beratit.

Ditët e ftohta të dimrit dhe puna e rëndë që bënin për shtrimin e rrugës Mbarezhdan-Berat, duke tajtur gurë, nuk i përkulën të rinjtë e dënuar. Morali i tyre qëndronte lart. Ndoci këtu ndikonte në krijimin e një ambienti të ngrohtë e gazmor në të gjithë të burgosurit.

Një shok i internuar bashkë me Ndocin tregon:

«Ndoci fliste shpejt, ishte komik i madh. Unë kam ndejur në një dhomë me të. Me ne ishin edhe Qemal Stafa e Vasil Shantoja, me të cilët bisedonim për të ardhmen; në pushime vazhdonin anekdotat me Ndocin, i cili i plaste së qeshuri të gjithë shokët. Ai tallte me humor të hollë xhandarët, oficerët, prefektët, pronarët e ndryshëm.

Dy-tri ditë para pushtimit fashist, na dërguan në burgun e Beratit. Atje, mbasi mësuam për përgatitjen e pushtimit të vendit, me anë të një telegrami i kërkuam qeverisë zogolliane armë, por ajo nuk na u përgjegj. Kur hyri Italia, kërkuam lirim, por nuk na liruan. Atëhere natën shpërthyem burgun dhe u arratisëm të ndarë në grupe. Me Ndoc Mazin u nisëm nga malet e Elbasanit, ku qëndruam dy tri-ditë deri sa doli amnistia, të cilën pushtuesit e përdorën për me mashtruar opinionin publik për gjoja demokraci të plotë etj.»

Ndoci u nis nga malësitë e Elbasanit dhe u ndal në Durrës. Ishte në një gjëndje të keqe



Një grup shokësh të kolektivës komuniste të Grupit të Shkodrës në Durrës. Mësisht tyre Ndoc Mazi e Fahri Ramadani.

ekonomike, por kjo gjë nuk e pengoi ta vazhdonte aktivitetin revolucionar, sidomos në punën me rininë durrsake. Natyra me humor e ndihmonte që të lidhej shpejt me të rinjtë dhe të kishte sukses në punën që i kishin ngarkuar.

Në fillim e pati të vështirë që të gjente qoftë edhe punë krahu, mbasi nuk i jepnin, por u stabilizua menjëherë sapo u takua me komunistin Fahri Ramadani, i cili punonte kryepunëtor. Punoi në ndërtimin e një hoteli në plazhin e Durrësit dhe më vonë kaloi si punëtor në port.

Ai dhe një grup shokësh, në mes të të cilëve ishin edhe Hajdar Dushi e Fahri Ramadani, krijuan «Kolektivën e grupit komunist të Shkodrës në plazhin e Durrësit», me përgjegjës Hajdar Dushin.

Anëtarët e kolektivit ishin anëtarë të grupit komunist ose nën ndikimin e tij. Shumica e tyre punonin si punëtorë, banonin së bashku dhe kishin për qëllim që me një pjesë të të ardhurave të tyre të ndihmonin shokët e burgosur e të internuar, të cilëve s'kishte ç'tu dërgonte familja, siç ishte Tom Kola e shumë të tjerë. Gjithashtu ndihmonin, me sa kishin mundësi, familjet e shokëve të burgosur, të cilave u mungonte edhe buka e ditës.

Kolektivi organizonte studimin e materialeve marksiste-leniniste që mundnin të siguronin atë kohë. Figura e Ndocit shquhej në mes shokëve për qartësi ideologjike e politike dhe ndihej ndikimi i tij në të gjithë shokët e grupit.

Gjatë punës në port ai pa edhe më qartë se si grabitej Atdheu. Por atje pa dhe njohu edhe je-

tën e punëtorëve, dëshirat e tyre, urrejtjen që kishin ata për pushtuesin e vendit, për tradhëtarët e në mes tyre u mbrujt edhe më tepër si revolucionar.

Themelimi i Partisë Komuniste Shqiptare e gjeti në Durrës, ku u pranua anëtar partie që në ditën e themelimit të saj, duke milituar denjësisht në të deri sa derdhi gjakun për çështjen e çlirimit. Ai u hodh më aktivisht e më me guxim në lëvizjen nacionalçlirimtare dhe e zgjeroi punën me rininë, duke parë në të një forcë shumë të madhe. Për aftësitë e tij u zgjodh sekretar organizativ i rinisë durrsake. Duke ju përmbajtur udhëzimeve të partisë që i merrte nëpërmjet Qemal Stafës dhe shokëve të tjerë, Ndoci i shtoi forcat për të organizuar rininë në luftën që po hidhte shtat.

Ndoc Mazi mori pjesë në mbledhjen e 23 nëndorit të vitit 1941, kur u themelua Organizata e Rinisë Komuniste Shqiptare. Disa nga të rinjtë që kishin ardhur nga krahina të ndryshme si Tirana për të njëjtin qëllim si edhe ai, kaluan gjithë natën para mbledhjes me shakatë e Ndocit. Por ata panë tek moshatari i tyre edhe një të ri serioz e të vendosur për të zbatuar detyrat e partisë. Shokët që punuan e luftuan me të gjithnjë e në çdo rrethanë e panë se te Ndoci kishin një shok të pjekur e të formuar.

Me t'u kthyer në Shkodër, Ndoci ju kushtua kryekëput çështjes së revolucionit. Burgu i Beratit, me revolucionarë të mëdhenj si Qemali, Vasili e të tjerë, të cilët e mbajtën afër Ndocin, puna me punëtorët durrsakë, e kalitën më shumë

ideologjikisht atë për të kryer më me vendosmëri detyrat e vështira që i ngarkonte partia.

Mbas demonstratës së shkurtit të vitit 1942, Ndoc Mazi u arrestua dhe trupi i tij i imtë ju nënshtrua përsëri torturave çnjerëzore, por ai prapë qëndroi ballëllartë dhe nuk u mposht.

Një i burgosur u deklamonte një ditë shokëve të tij këto vargje:

*«Nëpër hekra të kryqëzuem të dritares seme
shof qiellën të coptueme në katërdhetë copë
dhe shof diellin sa një pare serme,
aq larg asht dielli nga e emja gropë.*

*E kjo gropë e eme e ka emnin burg.
E dini se burgu nuk asht për dëfrim,
prandaj burg'i em asht shumë, shumë'i ultë
dhe më bani palmuç dhe më mbyti në
trishtim».*

Ndoci e shikonte me vëmendje shokun që recitonte dhe, sapo ky mbaroi, me ndërhyrjen e tij të shpejtë dhe me taket e ktheu atë çast mërzie në një optimizëm revolucionar. Duke qeshur, siç e kishte zakon, tregoi dhëmbët e tij të përparëm të thyer nga fashistët në tortura dhe tha:

— Ndoci Ndoc që Ndoc ka mbetë. Ne do ta bajmë tonën. A do ta bajmë, shokë? — ju drejtue disave.

— Do ta bajmë patjetër, — u përgjegjën ata. Ishte fjala për fitoren kundër pushtuesit dhe feu-

do-borgjezisë, për fitoren e revolucionit që kishin filluar.

Për mungesë provash, Ndocin e liruan nga burgu.

Në qershorin e vitit 1942, ai lëvizte sa në një bazë në tjetrën për të kryer detyrat e partisë, zbatimi i të cilave bëhej gjithnjë e më i vështirë. Komiteti qarkor i partisë po organizonte punën me rininë, duke ngritur aktive të rinisë në lagjet dhe në klasat e shkollave të qytetit. Ndoci ishte i ngarkuar të punonte me të rinjtë e disa lagjeve. Aktiviteti i tij ra prapë në sy të armiqve, prandaj shpejt filloi jetën e vështirë të ilegalit.

Spiuni Çun Hajdari kishte ditë që po e kërkonte. Ai gjurmonte sidomos shtëpinë e Jordan Misjes, të mësuesit komunist, që kishte filluar një aktivitet të dendur revolucionar në Pukë.

Perlato, Brankoja, Ndoci e shokë të tjerë e kishin kthyer atë shtëpi në një bazë të lëvizjes nacionalçlirimtare. Një ditë qershori të vitit 1942 Jordanin e thirrën për punë partie me një telegram «nana asht e sëmurë». Në shtëpinë e tij u organizua një takim. Perlato, Brankoja dhe Jordani prisnin shokun e tyre Ndoc Mazin. Ndoci atë natë doli nga një bazë në periferi të qytetit dhe u nis për në vëndin e takimit. Spiuni Çun Hajdari e diktoi, ju qep pas dhe e ndoqi me kujdes, mbasi Ndoci ishte i shkathët dhe mund t'i shkëputej ose t'i bënte ndonjë të pabërë. Në kohën kur Ndoci trokiti në portën e shtëpisë së Jordanit, spiuni u tur tërë gëzim për në zyrën e kuestorit dhe e informoi këtë se kishte zbuluar Ndoc Mazin. Por ky nuk ndënji atë natë në atë shtëpi dhe pa u

bërë rrethimi qe larguar për në një bazë tjetër. Në orën 1 mbas mesnate shtëpia u rrethua. Krisi pushka. Tre komunistë luftuan për orë të tëra kundër qindra fashistëve. Ata shkruan një faqe të lavdishme në historinë e Luftës nacionalçlirimtare. Ndërsa shoku i tyre Ndoc Mazi, bashkë me katër trima të tjerë shkruan më vonë një tjetër epike të lavdishme, atë të Buzabardhit në Vig.

Armik i klerit dhe i ideologjisë së tij

«Xhamiat dhe kishat madhështore ndër vende tona të mjerueme.

Kumbanoret dhe minaret e nalta mbi shtëpiat tona përdhecke».

Kështu shkruante Migjeni. Ushtonin kambanat e kishave, e jehonën e njëres e pasonte tjetra, e ajri mbushej me zhurmën e tyre monotone metalike. Në qarkun e Shkodrës numëroheshin rreth 100 kisha e kupola e mbi 700 priftërinj, murgesha e seminaristë. Të gjithë këta kishin arësim teologjik, ishin stërvitur për të luftuar çdo mendim përparimtar, lëvizjen demokratike e revolucionare. Kleri katolik ishte udhëheqës shpirtëror i klasës sundonjëse, ishte truri i saj. Aparati shtetëror feudo-borgjez, intelektualë, pronarë, tregëtarë dhe qeveritarë të ndryshëm përulëshin para klerit katolik. Feja dhe regjimi ishin bërë mbështetëse të njëri-tjetrit.

Kisha katolike me kinematë dhe institucionet e tjera që kishte, me shoqëritë kulturele dhe

sportive që pat krijuar si «Bijat e Zojës», «Antonianët», «Dom Bosko» etj., përpiquej që të luftonte sistematikisht komunizmin që po përhapej. E me këtë punë merreshin edhe disa organe të shtypit, që villnin vrer për partizanët dhe komunizmin. Ato e quanin pushtuesin «vëlla sipas fesë së Krishtit», ndërsa besimtarët katolikë i këshillonin që të «ruheshin nga lugati i kuq».

Ndoci banonte në qendrën e këtyre institucioneve, që grumbullonin moshatarët e tij. Prandaj ai e kishte të qartë se sa të rrezikshme ishin ato për luftën që kish filluar populli ynë. Ndoci e dinte se Dom Shestani drejtonte organizatën e rinisë katolike të Ballit Kombëtar, me emrin «28 nandor», e cila në fillim përpiquej aq shumë të tregohej përparimtare, ndërsa nga ana tjetër bashkëpunonte me forcat e SIM-it dhe denonconte të rinjtë komunistë dhe antifashistë. Vetë arqipeshkvi mbante lidhje të drejtpërdrejta me krejtë e reaksionit, duke drejtuar mbledhjet kundër lëvizjes nacionalçlirimtare.

Shoku Enver Hoxha ka thënë:

«Reaksioni i brendshëm dhe disa klerikë të lartë katolikë dhe muslimanë të Shkodrës kanë qenë kurdoherë të lidhur me armiqtë e jashtëm të popullit tonë, me shkelësit e huaj dhe regjimet antipopullore, kanë qenë vegla të turqve, të austrohungarëve, të fashistëve italianë, nazistëve gjermanë, Vatikanit dhe imperiaлизmit agresor dhe luftëdashës amerikano-

anglez etj. . . Ata muarën pozita të rëndësishme politike nën fashizmin dhe me egërsinë më të madhe u hodhën në luftë kundër popullit».

I ndjekur nga agjentët e rinisë së klerit, të cilët e kishin fillin e tyre në kuesturë, Ndoci u arrestua më 22 qershor të vitit 1942 dhe, mbasi e torturuan dy muaj në burgun e Shkodrës, e dërguan në burgun e Tiranës. Atje u sëmur rëndë nga torturat e egra që i kishin bërë, prandaj e dërguan në spital, nga ku arratiset bashkë me një shok tjetër.

Në Shkodër, me anë të shokëve të tij, bij hamejsh, muratorësh, druvarësh e të tjerë, Ndoci gjente baza të sigurta për teknikën e partisë, aktivizonte të rinjtë për shpërndarjen e trakteve dhe propagandonte në familjet qytetare Luftën nacionalçlirimtare. Puna e tij me rininë bëhej gjithnjë e më e efektshme, duke aktivizuar në aktivet e rinisë së lagjeve disa dhjetëra të rinj punëtorë, shëgertë e studentë. Duke predikuar në «Kishën e Madhe» të qytetit, një prift porosiste besimtarët që të mos i linin fëmijët e tyre të shoqëroheshin me «elementë jo të mirë, që nuk e ndigjonin e nuk e besonin kishën». Ishte fjala për Ndocin dhe dy-tre aktivistë të tjerë të asaj lagjeje, që grumbullonin rreth vetes disa dhjetëra të rinj, që filluan pastaj të mos shkojnë fare në kishë dhe të mos pyesin për predikimet e klerikëve. Dhe ky numër i të rinjve shtohet gjithnjë. Zgjerimi i rrethit shoqëror të Ndocit ishte zgjerim i aktivistëve të lëvizjes nacionalçlirimtare,

mbasi shokët e tij ai i inkadronte në grupet edukative të partisë dhe të rinisë, disa prej të cilëve pranoheshin pastaj në organizatën e rinisë komuniste, aktivizoheshin si shpërndarës traktesh, si korrrierë e ndërlihdës për shokët ilegalë dhe shokët e çetës në mal, bëheshin aktivistë të teknikës së partisë, gjurmonjës agjentësh të rrezikshëm etj. Këta të rinj shkëputeshin nga shoqëritë klerikale dhe nga ndikimi i Ballit Kombëtar, në saje të punës individuale e të diferencuar që bënte Ndoci me secilin. Kështu ai kryente detyrat e ngarkuara nga partia për ta larguar rininë nga shoqëritë kulturore e sportive të organizuara nga kleri, duke shpëtuar atë nga helmimi i tij.

Në raportin që komiteti qarkor i rinisë komuniste të Shkodrës i dërgoi me 1 nëntor 1943 Komitetit Qendror të Rinisë Komuniste Shqiptare në mes të tjerash shkruante:

«...Influenca e rinisë sonë mbi rininë antifashiste asht e madhe. Ndër të gjitha lagjet zhvillohen konferenca të shpeshta të rinisë antifashiste e komuniste bashkë. Asht popullarizue mirë «Bashkimi i Rinisë popullore Antifashiste Shqiptare». Rinia e tanë e ndjen veten antifashiste dhe, mbas demaskimit sistematik të reaksionit ndërkombëtar e të mbrendshëm, i urren reaksionarët gjer në kulm. Asht popullarizue mirë Shqipnia Demokratike e Popullore. Rinia asht vue e tana në korrent të situatës në të cilën po kalojmë, domethanë të kryengritjes së përgjithshme, për vendos-

jen e pushtetit popullor. Nga influenca që ka organizata jonë mbi rininë antifashiste, ka ba që të kemi edhe fitime organizative. . . Si në rininë antifashiste ashtu edhe në popull Balli Kombëtar dhe reacionarët zogistët janë demaskue mjaft mirë. Balli me politikën kundër Luftës nacionalçlirimtare, kundër Partisë Komuniste, pro okupatorit, me parullat e tij ka humbë kredinë para rinisë, e cila asht prej natyre përparimtare dhe demokrate. Në sa influenca e partisë dhe e KPNÇI-së asht mjaft e madhe në rini. Përveç një rinie të pavendosun dhe ma tepër pasanike reaksionare, Balli s'ka gja tjetër. . .

Me rininë katolike asht thye akulli. I vetmi sektor, ku fitimi asht i madh. Konferenca të gjana janë ba me këtë rini antifashiste dhe përfitimet kanë qenë të mira dhe vazhdojnë të jenë. . .

Kleri ka akoma, në një pjesë të mirë të rinisë katolike, influencë. Megjithatë rinia ka tregue shenja largimi nga klubet që ka kisha. Asht tregue e vendosun në ndamjen e trakteve, në ngjitjen e parullave në të gjitha lagjet katolike. Ka prej tyne që kërkojnë me dalë në çetë, që duen me marrë pjesë në njësitet guerile të qytetit. . . »

Në këtë punë të partisë me rininë dha kontributin e vet edhe Ndoc Mazi si anëtar i komitetit qarkor të rinisë, si komunist me përvojë në jetën.

revolucionare, si një kuadër i thjeshtë, popullor, gjithnjë gazmor, i rinisë dhe i komitetit qarkor të partisë.

Aktiviteti i Ndocit në qytet përqëndrohej në punën ilegale për shpërndarjen e trakteve, sigurimin e teknikës së partisë, punën e gjallë me aktivin e rinisë dhe me celulën e partisë, si dhe me bashkërendimin e veprimeve të shokëve ilegalë me shokët që kishin dalë partizanë në mal.

Në një ditë gushti të vitit 1943, kur u krye një kontroll i befasishëm në bazën ku ndodhej Ndoci, ky shpëtoi, siç thonë, për një qime dhe u largua bashkë me shaptilografin dhe materiale të tjera. Kjo rrëshqitje prej duarve të armikut ishte një «mrekulli», siç e quajtën shokët, e cila qe pasojë e një manovrimi të një ilegali me përvojë, që shpëtoi bazën nga një zbulim i sigurt i armikut. Pikërisht në valën e një aktiviteti të dëndur revolucionar në qytet, ndonëse i lodhur fizikisht nga torturat e egra të xhelatëve ndër burgjet e fashistëve, në pamundësi për të vazhduar punën në qytet, Ndoc Mazi kaloi në çetën e tretë të Batalionit «Perlat Rexhepi», nga ku, mbas pak, filloi aktivitetin në zonën Pukë-Mirditë.

Me armë në dorë, shpatit të malit

Me gjithë kërkesat e vazhdueshme të shokëve që të rrinte në ndonjë bazë të sigurt për të punuar me teknikën, Ndoci nuk pranonte, sepse e kuptonte se ata donin t'i krijonin lehtësi sepse ishte shëndetpakë. Ai nuk dëgjonte të shkëputej

nga shokët, që kishin dalur malit për liri, nga jeta partizane plot vështirësi e rreziqe.

Në dimrin e vitit 1943-1944, gjatë operacionit armik të dimrit, në Shkodër kishin shkuar qindra xhelatë të Xhafer Devës, të cilët filluan ndjekje, arrestime dhe vrasje. Ja, në ato ditë acari e terrori të egër, Ndoci zbriti në qytet me punë partie. Një shok i tij tregon:

«E pashë Ndoc Mazin tue hangër në një restorant, sapo ishte kthye nga mali. Ishte i maskuem, i ulun në një qoshe, me kasketën gati deri në sy. «Kam ardhë për disa punë të çetës, më tha, e me këtë rast po ha edhe një supë të nxehtë. Kemi harrue me hangër, shtoi tue qeshë, ashtu siç e kishte zakon ai».

Ndoci ishte një organizator dhe propagandist i mirë. Kur kalonte fshat më fshat me shokët e njësitit, në Thkellë të Mirditës arriti të krijonte një aktiv të vogël, me të cilin organizoi dy herë mbledhje. Atje te Qarri i Kabalit, midis Perlatit e Shebes, në të ftohtit e madh të shkurtit, foli e hapi horizonte të reja për të ardhmen e Mirditës e të vendit, për luftën e armatosur të malësorëve kundër Gjon Marka Gjonit e bajraktarëve, që i kishin drejtuar pushkët lëvizjes nacionalçlirimtare.

Kolla kishte filluar ta mundonte Ndocin, por ky nuk epej dhe nuk pranonte në asnjë mënyrë të mbetej në ndonjë bazë, megjithëqë kjo kërkesë i bëhej vazhdimisht nga shokët e partisë. Vazhdonte punën i papërkulur. Ai, me qëndrimin e tij të pam-

poshtur, bëhej frymëzim i madh për të gjithë shokët e njësitit.

Që nga takimi i fundit në Ungrej, kishin kaluar katër javë. Ndoci dhe shokët e tjerë të grupit morën rrugën për t'u bashkuar me shokët e tjerë, të cilët ishin shpërndarë në grupe të vogla. Por, në Buzabardh të Vigut, u rrethuan nga mercenarë të Gjon Marka Gjonit, të cilët s'lanë gjë pa përdorur për t'i zënë trimat të gjallë. Por partizanët u përgjegjën siç u kishte hije. Për qëndrimin e Ndocit rapsodi popullor këndon kështu:

*«... Flet Ndoc Mazi, aj far' trimi:
Sikur rrfeja e gjëmimi.
U thotë Ndoci: or ballista,
Parti mbreti, legaliteti,
Me një fjalë, jeni fashista,
Keni luftë me komunista
E me krejt popullin shqiptar,
Me puntor' e katundarë.
Le të vejë gjaku sikur ujë
Gjallë ne arm't s'i dorëzojmë kuej...»*

Krimi i bashibozukëve të Gjon Marka Gjonit nuk e frenoi vrullin e përhapjes së lëvizjes nacionalçlirimtare edhe në Mirditë. Lufta kundër pushtonjësve dhe tradhëtarëve po ashpërsohej ditaditës, ora e çlirimit po afrohej.

Shtëpia e Ndoc Mazit ishte kthyer në një bazë të sigurt, ku partizanët priteshin si në shtëpinë e tyre. Vëllezërit dhe shokët e Ndocit, që kishin filluar dhe ata luftën për çlirimin e vendit, e

vazhduan atë së bashku me 70 mijë shokë e shoqe partizane deri në fitoren e madhe të Luftës nacionalçlirimtare.

* * *

Për trimëri dhe vendosmëri, për qëndrimin heroik, Presidiumi i Kuvendit popullor e ka dekoruar Ndoc Mazin me titullin e lartë të Heroit të popullit, si dhe me Medaljen e Trimërisë, të Kujtimit, të Çlirimit dhe me Yllin Partizan.

Një lagje e madhe e qytetit të Shkodrës, një shkollë e re e qytetit, sanatoriumi i shtetit etj., mbajnë emrin e heroit. Kjo, sepse në epopenë e pavdekshme të Vigut, shkëlqeu madhështore edhe figura e Ndoc Mazit, e komunistit të orëve të para, i cili, duke shprehur mendimin e njëzëshëm të njësitit, në çastin e fundit shkroi me dorën e tij letrën që grupi i heronjve i dërgoi komitetit qarkor të partisë, letër e cila ka hyrë tashmë në faqet e Historisë së Atdheut tonë, si një dokument që u flet brezave të rinj për aktin dhe qëllimin e jetës së tyre me fjalët e fundit: «VDEKJE FA-SHIZMIT, LIRI POPULLIT!»

NAIM GJYLBEGU

(Besniku)

*«Nanat vetë na patën mësue
Ma mirë dekë se të marrue»*

(Popullore)

*«Sot lipset me flamurë
Malit të dalimë,
Përmbi shkëmbinj dhe gurë
Lirinë të ngjallimë.*

*Se mjaft në robëri,
O e mjera Shqipëri,
O djem rrëmbeni pushkëtë
Ja vdekje, ja liri...»*

Të gjithë ata që e kanë njohur thonë që Naimit i pëlqente shumë kjo këngë. E këndonte



Naim Gjylbegu

shpesh dhe ngazëllehej kur e shoqëronin shokët. Dhe këta e shoqëronin, jo vetëm pse kënaqej shoku i tyre, por pse edhe atyre u pëlqente shumë. Kur ish i vogël e vraponte në oborrin e shkollës së Parrucës, ai shpeshherë e linte lojën, librin që kish në dorë apo bisedën, për të dëgjuar këtë këngë, melodia e së cilës vinte nga dritarja e një klase. Njëri nga mësuesit e asaj shkolle e këndonte shpesh me nxënësit e tij. Ajo shkollë ishte e vetmja në Shkodër, që kishte ngritë një bandë me nxënësit e saj. Shumë herë me ta përzihej edhe Naimi dhe të parën merrte këngën e tij, që e kish mësuar që jashtë nga oborri. Me interesimin e mësuesve të shkollës, banda ishte plotësuar mjaft mirë me instrumente frymorë e gjithshka i duhej një bande të thjeshtë.

Me këtë këngë në gojë, më vonë ai drejtonte shokët e klasës në gjimnazin e shtetit, të cilët, në grupe, merrnin njëri pas tjetrit këngë patriotike, duke ua ndërruar shpeshherë edhe përmbajtjen, duke u dhënë një theks revolucionar, të lidhura me mendimet dhe qëndrimin e tyre për kohën që kalonin. E la gjimnazin pasi kreu vetëm dy klasë të kursit të ulët. Në rrethanat që ju krijuan në shtëpi, ai duhej të linte shkollën, të mësonte një zanat e të fillonte nga puna për t'i ardhur në ndihmë familjes.

Në këpucëtoren ku hyri shëgert, u njoh me shokë të rinj, punëtorë, të cilëve u hyri në zemër shoku i porsaardhur, djaloshi fytyrërrumbullakët, tek i cili shquhej gjithnjë një buzëqeshje e çiltër, që u jepte syve të zez shprehje gazmore.

Trupi i tij mesatar dhe gjoksi pak i dalë e i

shëndetsëm, edhe pse me orë të tëra ai kalonte në punë i kërrusur mbi këpucët që meremetonte, nuk u deformuan, përkundrazi, nga puna e nga sporti u zhvilluan edhe më tej. Por Naimi u zhvillua më shumë shpirtërisht, sidomos me miqësinë që krijoi me shokët e tij të punës, me këpucëtarët shegertë. Në dyqan punonte edhe një anëtar aktiv i grupit komunist të Shkodrës, i cili bënte pjesë në krahun e shëndoshë të atij grupi. Ai ndikoi te Naimi, e njohu me elementë të mirë revolucionarë dhe e futi nën ndikimin e tyre.

Natyra e çiltër dhe karakteri i pastër, të folurit e ngadaltë, të matur, por të gjallë të Naimit e afruan me shumë të rinj, të cilët dëgjonin me kënaqësi shokun e tyre,

Pushtimi fashist italian i vuri Naimin dhe shokët e tij para detyrave të reja e të ndërlikuara. Ata e kuptonin se mbi popullin tonë tani rëndonte edhe shtypja nga feudo-borgjezia e vendit, edhe nga pushtuesi italian, që synonte të italianizonte e fashistizonte vendin tonë. Si i ri revolucionar, që mbante lidhje me grupin komunist dhe ishte nën ndikimin e tij të plotë, Naimi u aktivizua gjallërisht në protestat, që bëheshin kundër shkelesit të huaj dhe veglave të tij.

Në demonstratën e 28 nëntorit të vitit 1939, kur masa e rinisë shkodrane marshoi në rrugët e qytetit, duke qëlluar konsullatën italiane, duke i thyer xhamet e duke dëmtuar dyert e saj, Naimi u tregue i papërmbajtur; ai lëshonte parulla dhe herë mbas here këndonte së bashku me shokët e tjerë këngën e dashur:

«*Se mjaft në robëri,
O e mjera Shqipëri.*»

si dhe

«*Vlora, Vlora . . .*»

Një djalosh trupmadh, me zë basi, i gjendej gjithnjë pranë; ai e shoqëronte në demonstratë me zërin e tij të fortë, melodioz, që nxiste për këngë edhe masën tjetër të rinisë. Ishte punëtori komunist Vaso Kadia, shoku i afërt i Naimit. Vrulli revolucionar i këtyre të rinjve ishte i madh, dëshira e tyre për të luftuar kundër çizmes së rëndë të vandalëve të përtejdetit dhe tradhëtarëve të vendit ishte e zjarrtë. Por ata nuk kish kush t'i drejtonte. Partia komuniste ende nuk ishte krijuar, ndërsa, midis anëtarëve të grupit komunist, nuk kishte unitet mendimi e veprimi. Prandaj, megjithëqë përpjekjet e një grupi shokësh, veçanërisht të konviktorëve të konviktit «Malet tona», ishin shumë të mëdha, përsëri suksesi i demonstratës ishte i kufizuar.

Për pjesërmaje aktive në demonstratën e 28 nëntorit të vitit 1939, Naimi u arrestua dhe u mbajt i mbyllur disa ditë në qeli.

Qëndrimi i Naimit dhe i shokut të tij Vaso Kadia në burg ishte burrëror. Ata përballuan ballëllartë torturat e egra të xhelatëve dhe jo vetëm që nuk u lëkundën, por u bënë edhe më të vendosur për të luftuar me çdo mënyrë bishat fashiste dhe veglat e tyre. Atje Naimi dha provimin e parë të

vendosmërisë dhe të besnikërisë së tij për rrugën që kish nisur.

Mbasi dualën nga burgu, Naimi dhe Vasoja u lidhën edhe me shokë të tjerë dhe ju shtua edhe më shumë dashuria vëllazërore për njëritjetrin. Ata e vazhduan aktivitetin revolucionar, Në vendin e punës së Naimit kishte shumë shegertë, prandaj Vasoja bisedonte me të me zë të lartë që të dëgjonin edhe të tjerët dhe të merrnin vesh lajmet e reja; njëkohësisht diskutonin për filma që shikonin apo për ndonjë libër që u binte në dorë.

Naimi u njoh edhe me shokë kryesorë, si me Qemal Stafën e Vasil Shanton, bashkëpunoi me Perlat Rexhepin e të tjerë. Lidhjet me shokë të formuar ndikuan në formimin e mëtejshëm të Naimit, aq sa, pak muaj mbas themelimit të partisë, në maj të vitit 1942, u pranua anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare.

Në krye të grupeve edukative të partisë, Naimi u tregua kërkues ndaj vetes së tij, në radhë të parë, duke studjuar me durim materialet e përkthyer, që i binin në dorë dhe përpiquej t'ua punonte në mënyrë të qartë e të thellë dëgjuesve, që i ishin besuar. I ngarkuar nga Komiteti qarkor i partisë, Naimi organizoi disa aktive rinie në lagje, duke përfshirë këtu edhe aktivin që drejtonte shoku i tij i fëminisë Ahmet Haxhia, Një shok, në kujtimet e tij, shkruan:

«Në vitin 1941, në fundin e vjeshtës, isha ushtar në batalionin «Tarabosh» të ushtrisë së vjetër, në Ulqin. Nga fillimi

i nandorit erdha në Shkodër me leje. Tue shëtitë nëpër rrugë, takoj Naim Gjylbegun, i cili, mbasi u përshëndet, më tha: «Mos u nis nesër në Ulqin, mbasi me ty do të takohet nesër një shok, me të cilin keni qenë bashkë në shkollën teknike». Unë pranova. Të nesërmen dola në takim në vendin dhe orën e caktueme, ku u gjeta përballë Naimit dhe Perlat Rexhepit. Perlati më buzëqeshi, më shtrëngoi dorën për zemërsisht dhe m'u drejtue: «Ja si u takuem përsëri mbas bankave të shkollës». Të tre së bashku shkuem në shtëpinë e Naimit dhe qëndruem tri orë në dhomën e tij, nalt në trapazan. Aty biseduem dhe kuptova plotësisht detyrën që më ngarkuen. Në Ulqin jemi takue edhe herë të tjera me Naimin dhe kemi bisedue për punën në ushtri, për të krijuar lidhje me popull, me i përgatitë ushtarët që të dezertojnë me armatime etj. Kur vijshe në Shkodër, Naimi më jepte komunikata për t'i shpërnda në Tivar dhe Ulqin, në ushtri e popull».

Në demonstratën e shkurtit të vitit 1942, në veprimin e parë të organizuar dhe masiv të komitetit qarkor të partisë, Naimi mori pjesë aktive në bashkërendimin e veprimeve në mes të studentëve të gjimnazit, që ndodheshin në kinema (të cilët do të fillonin protestën brenda në sallë), dhe të punëtorëve, që prisnin jashtë. Naimi me punëtorë të tjerë prisnin në krye të rrugës dhe prej

andej u bashkuan me studentët, duke lëshuar parullat: «Poshtë fashizmi!, Rroftë Partia Komuniste Shqiptare» e duke filluar këngën e tij të dashur:

*«Se mjaft në robëri,
O e mjera Shqipëri,
O djem rrëmbeni pushkëtë,
Ja vdekje, ja liri...»*

Gjatë demonstratës fashistët treguan egërsinë e tyre prej bishe. Ata hapën zjarr dhe midis demonstruesve pati të vrarë e të plagosur. Naimi me shokë të tjerë strehoi te njerëzit e tij komunistin Tom Kola, i cili ishte plagosë në demonstratë e sipër.

Naimi, si element revolucionar e pjesëmarrës aktiv në këtë demonstratë, shpejt u arrestue, së bashku me disa të rinj të tjerë.

Kësaj radhe fashistët dhe veglat e tyre provuan mbi trupin e të riut tortura më të përbindshme. Por Naimi nuk u përkul as nga xhelatët dhe as nga uria e gjatë. Qëndrimi i tij heroik u bë frymëzim i madh për rininë e Shkodrës. Nga torturat dhe vuajtjet e mëdha në burg, Naimi humbi për një kohë të gjatë edhe të pamit, i ranë edhe shumë dhëmbë, por moralisht qëndroi shumë lart e madje përpiqej të kujdesej edhe për shokët. Një mik i tij shkruan:

«... Më morën në kuesturë dhe më përplasën në një qeli atje në shtëpinë e Rrojit. Nji natë, nji poterë e madhe në

korridor më zgjoi trembshëm nga ai gjumë i përçartë, që po bajshe në çimento. Mbas njimijë kërcitjesh metalike çelsash e shulash, dera u hap, e një njeri u përplas ndër këmbët e mia, i shtyem nga policët. Në atë gjymsaterr, unë njofta në fytyrën e përgjakun buzëqeshjen e Naimit. Edhe ai më njofti mue. U përqa-fuem. Ashtu në atë gjendje të vajtueshme, që e kishin katandisë torturat mizore të atyre përbindshave, atij i ra në mend të kujdesej për mue.

— Oh, ti ke temperaturë, mor shok,
— tha i pikëlluem, tue ma vue dorën në ballë. E sa fjalë të mira, inkurajuese shqip-tuen buzët e tij! Sa të fortë e ndjejsha veten bri tij>

Në burg, bashkë me Naimin ndodheshin edhe shokët e tij Ahmet Haxhia, Ndoc Mazi, Reshit Rusi (dëshmor) e të tjerë. Ata i karakterizonte një solidaritet i shëndoshë komunist, që ndikoi në edukimin e të gjithë të burgosurve. Gardiani i burgut, Caf Dani, sillej shumë keq. Ai ishte një spiun i fëlliqur dhe përpiquej të zbulonte dhe të shkatërronte organizimin e brendshëm që kishin vendosur vetë të burgosurit, veçanërisht të burgosurit politikë. Prandaj u vendos që të rrihej për vdekje ky agjent dhe t'i jepej kështu një mësim i mirë atij dhe njerëzve të tjerë, që vepronin si ai. Këtë gjë u caktue ta fillonte Reshit Rusi me Naimin. Dhe ata ja gjetën rastin, e rrahën aq shumë sa e lanë të shtrirë pa ndjenja. Por rrahja nuk u bë



Naim Gjylbegu, dëshmori Reshit Rusi, Pjetër Kosta e
shokë të tjerë në burg më 1942.

vetëm nga këta të dy, mbasi të gjithë të burgosurit, kush më shumë e kush më pak, i dhanë nga disa grushta e shqelma atij agjenti. Kur e mësoi këtë ngjarje karabinieria, u alarmua, rrethoi burgun, duke vënë armatime në hyrjet kryesore të tij. U bllokua çdo dalje; në burg u bë një rrëmuje.

Disa të burgosur ordinerë, me të cilët Naimi kishte biseduar shumë herë për qëllimin e lëvizjes nacionalçlirimtare, ju afruan dhe i thanë:

— Me ju komunistët vdesin sonte, po qe nevoja, edhe mirditasit.

Drejtori i burgut mblodhi të burgosurit për të gjetur shkaktarin e asaj «hataje të madhe që kishte ndodhur». Dhe ishte shumë i shqetësuar, mbasi kishte ardhur në një kohë jo të zakonshme, pse ishte edhe ramazan e drejtori agjëronte.

— Kush e bani këte? — pyeti ai i zemëruar..

Askush nuk ju përgjegj. Ndërsa drejtori çirrej së thirruri e kërcënonte se do të merreshin në qafë të gjithë, po të mos e tregonin «fajtorin», doli Naimi me hap të qetë e të sigurt.

— Unë e rraha, — tha, duke ju afruar drejt-përdrejt.

— Edhe unë, — ja priti Ahmet Haxhia, duke ndjekur shokun e tij.

— Pritni, more, po mue ku po më leni? — u hodh Ndoc Mazi. — Ju e patë sa shumë i rashë unë.

Qeshën të gjithë të burgosurit e ndërkohë secili thoshte për veten e vet se e kishte qëlluar atë të poshtër.

Sapo u lirua nga burgu, pa u shmallur mirë me njerëzit, edhe pse ishte djalë i vetëm, Naimi

u hodh në çetën partizane ballë për ballë me armikun.

Në shtëpinë, ku lindi e u rrit, është vendosur një pllakë përkujtimore, ku shënohet se ajo shtëpi ka qenë një ndër bazat e rëndësishme të Luftës nacionalçlirimtare. Atje strehoheshin shokë ilegalë dhe nënë Gjylafja priste e përcillte djemtë e saj, siç i quante ajo partizanët. Kjo grua trimërieshë dinte mjaft baza të rëndësishme në Shkodër, ku punonin shokë ilegalë, si atë ku ndodhej teknika e partisë etj. Në to dërgonte letra e materiale të ndryshme, duke aktivizuar edhe vajzat e saj, të cilat u bënë pioniere aktive të Luftës nacionalçlirimtare.

Në Batalionin «Perlat Rexhepi», partizani komunist Naim Gjylbegu u takua me Ndoc Dedën, me të cilin lidhi miqësi, e cila më vonë u forcua shumë e u përjetësua me gjakun e tyre që dërdhën së bashku në epopenë e Vigut.

Në çetë, Naimi u rrit edhe më shumë shpirtërisht, u kalit ideologjikisht dhe u stërvit ushtarakisht për të luftuar pushtuesin dhe veglat që i shërbenin atij.

Ishte periudha e thellimit të kryengritjes së madhe të armatosur, e shtimit gjithnjë e më shumë të forcave partizane në luftë kundër nazi-balistëve dhe reaksionarëve të tjerë. Naimi u bë komandant i çetës së tretë të batalionit.

Kur Batalioni «Perlat Rexhepi», me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, kaloi thellë në Veri, Naimi me disa shokë të tij u hodh në zonat e tjera të mallësisë për të organizuar qëndresën kundër pushtuesve, për të demaskuar reaksionin, që ishte gru-

mbulluar në atë zonë si dhe për të propaganduar lëvizjen nacionalçlirimtare.

Në dimrin e vitit 1943, Naimi ishte anëtar i komitetit qarkor të rinisë dhe komisar i çetës së Krujës. Atëhere shpërtheu reaksioni i tërbuar për të shkatërruar lëvizjen nacionalçlirimtare. Naimi me një grup prej 6-7 vetash u nis për në Dukagjin. Ata kishin për detyrë që të siguronin shpinën e Batalionit «Perlat Rexhepi» si dhe të punonin për krijimin e një çete partizane me fshatarë vendas. Duke luftuar me shumë durim me kushtet jashtëzakonisht të vështira të motit dhe me urinë, duke luftuar edhe me ndikimin e madh të bajraktarëve e të klerit, ata arritën të hedhin bazat për të krijuar çetën e Dukagjinit.

Mbas nja dy javësh, nga fillimi i janarit të vitit 1944, pjesëtarët e grupit zunë vend në Shpellën e Qershisë, në Urë të Shtrejtë, ku qëndruan shumë ditë në një shpellë pa ujë, duke shtrydhur dëborën e maleve.

Në jetën e vështirë partizane, Naimi interesohet për njohjen e mirë e të thellë të krahinës, të shtigjeve, të bazave rezervë etj. Ai e kishte të zhvilluar frymën e kritikës, tregon një shok i tij, nuk pajtohej me të metat, ndreqte shprehjet apo vepri-met e gabuara të shokëve, sidomos kur ishte fjala për taktikën partizane ose për çështje ideologjike dhe pastaj, që të mos fyente, qeshte: «A ta bana mirë?» Ai nuk dinte të fshihte gjë, ta thoshte hapur mendimin e tij, me dashamirësi e plot sinqeritet, e mandej pyeste: «A asht kështu?»

Njësitë partizan vazhdonte të kryente misionin e tij në Malësinë e Mirditës dhe të Lezhës. Gjith-

një e më shumë rritej figura e Naimit dhe e shokëve të tjerë të njësitit.

Naimi ishte i vëmendshëm ndaj shokëve. Korrieri i grupit, që kishte zbritur në Shkodër për lidhje me komitetin qarkor të partisë, u takua edhe me nënën e Naimit, e cila i dha një xhaketë për t'ja çuar djalit në mal. Dhe ai, sapo u kthye në njësit, deshi t'ja dorëzonte xhaketën Naimit, por ky ju përgjegj:

— Shiko veten si je, me një xhaketë krejt të hollë, kurse unë nuk e kam të keqe. Xhaketën do ta mbash ti. Ajo asht e jotja.

«Për t'i kundërshtuar, — tregon korrieri, — ishte e kotë. Por edhe unë nuk e mbajta, mbasi ishte xhaketë shumë e trashë dhe më shumë kishte nevojë për te ato ditë Ahmet Haxhia, i cili sapo kishte kaluar një palë ethe. Kështu, xhaketa, e dërguar për Naimin, i mbetet Ahmet Haxhisë. Kjo asht diçka e vogël, por një nga treguesit e shumtë të vëmendjes së partizanëve, për shokun e grupit».

Në çastin e rrethimit ashtu si përpara torturave të xhelatëve kur ishte në burgun fashist, qëndrimi i Naimit ka qenë shembullor. Atë qëndrim e këndon kështu rapsodi popullor: ,

*Ç'ka po thotë Naim Gjylbegu:
Del, kryetar, n'at fushë bejleku,
Mos u mshifni ndër kaçuba,
N'ato brigje edhe curra,
Delni n'shesh, vriti me burra,
Edhe kurr mos e mendoni
Se për laku ne na çoni.*

Naimi ra mbasi hodhi në strofkën e pritës një granatë, e fundmja bombë që i kishte mbetur.

* * *

Presidiumi i Kuvendit Popullor e ka dekoruar Naim Gjylbegun me titullin e Heroit të Popullit, me Urdhërin e Trimërisë, dhe me Medaljen e Kujtimit, të Çlirimit, të Trimërisë.

Shokët e tij, së bashku me nënën e Naimit e pjesëtarët e tjerë të familjes, e vazhduan çeshtjen, për të cilën ra shoku dhe biri i tyre.

Nëna e Naimit, komunistja Gjylafe Gjylbegu vazhdon gjithnjë të kryejë detyra shoqërore, t'i shërbejë revolucionit me optimizëm revolucionar, pa pyetur për vitet, që i rëndojnë mbi shpatulla. Në gazetën «Vullnetari» (fletë e «Zërit të Rinisë»), Nr. 5, të datës 1 mars 1967, në vendin e krye-artikullit është shkruar me shkronja të mëdha:

«Letër nga nëna e heroit Naim Gjylbegu,
Komitetit Qendror të BRPSH

Tiranë

Nuk besoj që të ketë njeri në republikë që të mos përfshihet nga ky vrull revolucionar, e veçanërisht ju të rijtë.

Edhe unë, megjithëse në një moshë të kalueme, dëshiroj, edhe sadopak, të kontribuoj në ndërtimin socialist të vendit.

Jam nana e heroit Naim Gjylbegu, me një moshë të thyeme, por me zemër të re. Vitet e luftës ishin me të vërtetë vite të stuhishme, por këto vite janë edhe ma

të vrullshme, që duen po aq punë e sakrifica.

Kur biri im Naimi u nis për Mirditë, e putha dhe i dhashë lamtumirën e s'e pashë ma. Tashti nji ditë nipi jem erdhi nga shkolla ma i gëzuem se ditët e tjera e më tregoi se kish dalë vullnetar për hekurudhë. E putha e mendja më shkoi te Naimi, që sigurisht edhe ai do të kish qenë gati me shkue në hekurudhë. Por njisoj. Ai shkoi vullnetar për një çështje të madhe, kurse ju po shkoni sot për një çështje tjetër po aq të madhe, po shkoni të ndërtoni udhën e hekurt, ta çoni atë ma tej që të shpejtohet ndërtimi socialist në vendin tonë, që të rritet fuqia e tij.

Pra, thashë edhe në fillim se edhe unë kam dëshirë të vazhdoj kontributin tim edhe në ndërtimin e hekurudhës Rrogozhinë-Fier.

Punë për mue do të ketë edhe atje, e sado e randë goftë, unë do të mundohem ta baj, nuk do të dorëzohem, se atje do të jem me ju. Vrulli juej do të më pushtojë edhe mue, se zemra ime rreh me tuejën, ajo rreh me kohën e jo me vitet që kalojnë.

Atje, mbas punës, do t'ju tregoj për të kaluemen tonë, për vitet heroike të luftës, që ju nuk i njoftët, nuk i jetuet.

Pra më pranoni, mos shikoni vitet e mia.

Përshëndetje revolucionare

Gjylafe Gjylbegu»

Shkodër, 20.II.1967.



Dy shokët e ngushtë, Naim Gjylbegu e Ahmet Haxhia

Dhe nëna Gjylafe e kreu aksionin e u kthye me shënjën «S» në gjoks.

Duke kërkuar dokumenta, fotografi, kujtime e gjurmë të tjera të heroit, gjetëm një fotografi, në të cilën Naimi ka dalë me shokun e afërt e të vjetër Ahmet Haxhinë. Të dy heronjtë i kanë hedhur dorën në brez njëri-tjetrit dhe qeshin e shikojnë me optimizëm. Po kështu kanë dalë edhe me Ndoc Dedën në çetë, kështu janë përjetësuar të pesë heronjtë në mendjet e në zemrat e popullit dhe të rinisë sonë, e cila do të ndalet gjithnjë para tablove realiste kushtuar Naimit dhe shokëve të tij, pranë monumenteve që populli u ka ngritur për t'i përjetësuar në Atdheun tonë të lirë e krenar, për të cilin ata flijuan jetën e tyre të re.

AHMET HAXHIA

(TIGRI)

Tigër i vërtetë, ashtu siç e kishte edhe pseudonimin, ishte Ahmet Haxhia për armiqhtë, të cilët i godiste m'u në strofkën e tyre, m'u në zemrën e tyre të pështirosur, në «folenë e plehrave, në kuesturë» e në qendra të tjera nevralgjike për fashizmin dhe veglat e tij vendase. Ai ishte më i dashuri, më i qeshuri, më trimi dhe më i mbajturi në mes të të rinjve aktivistë të Shkodrës, shok për kokë e i pandarë i Malit (Manush Alimanit).

* * *

Komiteti qarkor i partisë për Shkodrën, ashtu si e gjithë partia, i kushtoi vëmendje të veçantë punës me rininë. Këtë punë e bënte me të rinjtë e shkollave dhe të lagjeve, veçanërisht me shegertët dhe punëtorët e kategorive të ndryshme, si



- Ahmet Haxhia

edhe me ata të disa zonave të malësisë dhe të fushës, me të cilët u ngritën aktive të rinisë. Për ngritjen dhe gjallërimin e këtyre aktiveve, organizata e partisë e Shkodrës kishte ngarkuar anëtarët e saj, ndër të cilët ishte edhe komunisti Naim Gjylbegu. Naimi punoi edhe për ngritjen e gjallërimin e aktivitetit të rinisë në lagjen «Zadralej», nga i cili më vonë dualën disa grupe revolucionarësh të rinj komunistë. Për këtë qëllim ai bashkëpunoi me shokun e tij të ngushtë të fëmënisë dhe të lagjes, të riun Ahmet Haxhia, i cili u bë drejtues i aktivitetit të rinisë së kësaj lagjeje, duke u lidhur me një miqësi të ngushtë me Naimin, miqësi që e çelnikosi çështja e revolucionit, të cilit ja kishin kushtuar jetën e tyre që të dy. Ata u lidhën në miqësi që të mbeten si shokë të përjetshëm në faqet e arta të Historisë së popullit dhe të partisë sonë, të Luftës nacionalçlirimtare, duke shkruar me gjakun e tyre dhe të tre shokëve të tjerë epopenë e lavdishme heroike të Vigut.

Në aktivin e lagjes

Pa mbaruar klasën e tretë të gjimnazit të shtetit, të sistemit të vjetër, posa kishte shkëlur në të gjashtëmbëdhjetat, Ahmeti u largua nga shkolla për t'i ardhur në ndihmë familjes, e cila kish rënë ekonomikisht. Mbasi shkoi nga Shkodra në Tiranë për të gjetur punë, Ahmetit i forcohet më shumë bindja, që i ziente në kokë që në gjimnaz, se duhej hedhur në luftë të hapur për të dëbuar pushtuesit fashistë e veglat e tyre, për të ndërtuar një Shqi-

përi pa shfrytëzonjës, të lirë dhe demokratike, ashtu si i kishin thënë disa shokë në gjimnaz. Edhe në Tiranë, kur punonte në një dyqan, Ahmeti u lidh me shokë që aktivizoheshin në veprimtari revolucionare, duke e bërë shpeshherë dyqanin një qendër takimesh, ku, siç thonte ai, «zhvilloheshin biseda të mshefta».

Kështu ai erdhi në Shkodër, mbasi kishte kaluar fazën përgatitore, mbasi kishte përforcuar në Tiranë idetë revolucionare të lindura në gjimnazin e Shkodrës. Naimi dhe Ahmeti gjetën njëri-tjetrin për t'u thelluar në rrugën e tyre revolucionare. Nëpërmjet Naimit, i cili e ushqente dhe e frymëzonte për të gjallëruar edhe më tej punën me të rinjtë, Ahmeti merrte porositë e partisë, porositë e komitetit qarkor, të cilat i vinte në jetë në mënyrë krijonjëse, shembullore. Ata ngritën shoqërinë sportive «Rilindja», e cila erdhi duke u zgjeruar me të rinjtë nga lagjet e afërta. Nëpërmjet kësaj shoqërie, nën maskën e aktiviteteve sportive, organizohej puna politike e rinisë komuniste, nën drejtimin e partisë. Ahmeti organizoi kampionatin e futbollit të disa lagjeve, si të Perashit, Zdraljes, Tophanës, etj. Në ndeshjet që bëheshin grumbulloheshin me qindra të rinj dhe banorë të lagjeve, amatorë të futbollit. Me të rinjtë që luanin dhe me tifozët bëheshin, ashtu «rastësisht», biseda politike para ndeshjes, u shpërndaheshin trakte të partisë, që përhapeshin në të gjithë fushën dhe mbahej heshtje për shokët e rënë në luftë. E për këtë rastin e fundit veprohej kështu: gjyqtari ndërpriste lojën dhe njëri nga të rinjtë propozonte të mbahej një minutë heshtje

në shenjë kujtimi për shokët e rënë në luftë kundër fashizmit.

Këto aktivitete zhvilloheshin në fushën e Përashit të Kuq, në Xhabiej dhe sidomos në Lamiej.

Ahmeti ishte një ndër aktivistët më të aftë të komitetit qarkor të rinisë. Ai luante me të rinjtë, këndonte me ta, i drejtonte në veprimtari revolucionare dhe ndonjë armikut i tregonte edhe grushtin apo grykën e revoles.

Një ditë Ahmeti bisedoi me një shok që të dielën të bënin një piknik. Dhe kështu, pak njëri e pak tjetri, e hapën fjalën e u zgjerua rrethi i shokëve, që do të merrnin pjesë; secili nga shokët e aktiviteti bëri përgatitje me grupe të veçanta dhe, «ashtu rastësisht», atë ditë të bukur pranvere në drejtim të kalasë «Rozafat» u nisën grupe-grupe shumë banorë të qytetit, pjesa dërmuese e të cilëve ishin të rinj.

I ngjitej Tigri kalasë me mandolinën krahëve e dukej sikur kishte kapur pushkën për liri. Fytyra e tij tregonte gëzim. Herë-herë ai ndalej dhe hidhte shikimin prapa, poshtë nga vinin grupe qytetarësh njëri pas tjetrit. Dhe fëmijët nuk mungonin.

Grupet zunë vend në anë të ndryshme të kalasë, pranë mureve të mëdha e të trasha, nga ku shihej si në pëllëmbë të dorës qyteti i Shkodrës, kurse, nga ana tjetër, Ura e Bahçallëkut me ujërat dhe fushat përreth. Kjo shpërndarje nëpër hije nuk i pëlqeu Ahmetit. Për t'i grumbulluar, ai dhe katër a pesë shokë të tjerë filluan të këndojnë disa këngë popullore. Kënga pasoi këngën, dhe njerëzit nisën të mbledheshin rreth «këngë-

tarëve» për të dëgjuar meloditë e zgjedhura popullore. Pasi pa se rreth e rrotull ishin grumbulluar mjaft njerëz, Ahmeti kaloi në këngë patriotike e revolucionare. Ushtuan fjalët:

«Se mjaft në robëri,
O e mjera Shqipëri,
O djem, rrëmbeni pushkëtë,
Ja vdekje, ja liri.

Kjo melodi që u këndua nga të gjithë të pranishmit, u pasua me këngët «Bandiera Rossa» dhe «Fusha, ju fusha». Pastaj Ahmeti, kur gjeti rastin e përshtatshëm, u çua në këmbë. Era i lëvizte mbi ballë flokët gështenjë dhe jaka e bardhë e nxjerrë mbi xhakëtë ja hijeshonte edhe më shumë tiparet e këndshme të fytyrës. Nisi të flasë:

«Shokë,

Sot ka ardhë koha që secili nga ne t'i vejë gishtin kokës e t'i thotë vetes: «Ç'ba j unë për atdheun, për Shqipërinë? Këmishzeztë fashistë po përdhunojnë keqas popullin tonë, ata kërkojnë me zhdukë gjithshka shqiptare».

Ahmeti lëvizi pak, shtrëngoi në dorë «beretën» që mbante në xhepin e pantallonave, të cilën e kishte sjellë nga Tirana, dhe vazhdoi:

«Bijtë e vërtetë të Shqipërisë, bijtë e Skënderbeut, që për 20 e sa vjet i dërmoi ushtritë push-tuese turke, kanë marrë përsëri malet për t'u thye brinjte pushtesve. Tashti ka ardhun koha për ata që kanë gjak shqiptari të mendojnë ma shumë për fatet e popullit, të Shqipërisë.

Rinia komuniste shqiptare, nën udhëheqjen e partisë, e ka fillue luftën e vet në male dhe në kushte ilegale e gjysmëilegale edhe në qytete».

Ahmeti nxori nga gjoksi një trakt të partisë dhe e lexoi; dy shokë të tjerë, pa u vënë re, shpërndanë ndërkohë disa dhjetëra kopje të këtij trakti.

Në organizimin e këtij aktiviteti, Ahmetit i ndihmoi shumë një burrë pak thatim, me mustaqe, i cili, kur u kënduan këngët patriotike e revolucionare, mori zjarr me atë violinën që s'e lëshonte nga dora. Ishte mësuesi komunist Salo Halili. Ky kishte qenë mësues i Ahmetit në shkollën fillore dhe tani të dy ishin bërë shokë të afërt, të vëllazëruar nga ideali i përbashkët.

Ja, kështu, nëpërmjet lojërave, sporteve, shëtitjeve, këngëve, të cilave herë-herë ua ndryshonte edhe përmbajtjen dhe nëpërmjet formave të tjera, Ahmeti punonte me të rinjtë, u fliste mbi gjendjen ndërkombëtare, demaskonte para tyre fashistët dhe veglat e tyre, u ngrinte lart ndjenjën kombëtare, i organizonte dhe i aktivizonte për punë të ndryshme partie.

Në verën e vitit 1942, Ahmetin e arrestuan. Në burgun e Shkodrës kishte atë kohë rreth 300 veta, ndër të cilët 40-50 ishin shokë të lëvizjes nacionalçlirimtare dhe njiheshin si të burgosur politikë. Atje vepronte organizata e partisë, vepronin komunistët e bashkë me ta edhe Ahmeti, i cili ishte pranuar në rininë komuniste që në marsin e atij viti. Midis të burgosurve propagandohej vija e partisë, demaskohej pushtuesi dhe vegjati e tij. Lidhja e të burgosurve në mes njëri-tjetrit ishte shumë e fortë, me gjithë përpjekjet e drejtuesve

të burgut për të futur midis tyre përçarje me anën e ndonjë provokatori. Dhe përpara vendosmërisë dhe kompaktësisë së tyre dështonin intrigat dhe planet e fashistëve. Kështu ngjau, fjala vjen, kur pushtuesit deshën të internojnë në Itali disa të burgosur. Sapo e morën vesh qëllimin e armikut, komunistët morën masa të shpejta për të kundërshtuar internimin e shokëve. Ata shkatërruan disa banja dhe pregatitën tulla për mbrojtje, mbushën me pluhur shishet që kishin dhe të gjitha këto ua vërtitën në kokë fashistëve kur këta u përpoqën t'u merrnin shokët. Kjo vendosmëri i detyroi armiqtë të tërhiqeshin, duke pasur frikë nga pasoja të tjera më të hidhura.

Më 22 qershor të vitit 1942, në fushën Fierej, u shkrua një epike e lavdishme nga Perlat Rexhepi, Jordan Misja dhe Branko Kadia. Akti i tyre heroik tregoi se si qëndrojnë partizanët, komunistët para armikut, u tregoi të gjithëve si duhej luftuar për çlirimin e vendit. Ai u dha më shumë guxim edhe të burgosurve, të cilët nisën të këndonë:

*Drita dalë ka herë,
Po troket një derë,
Çilnje, more të mjerë,
Se nuk ikni dot.*

Kjo këngë u këndua për herë të parë nga dyzet e sa të burgosurit politikë, midis të cilëve ndodhej edhe autori i saj, Kolë Jakova, e pastaj çau muret e burgut, u përhap në qytet, nëpër

fusha, ju ngjit malit e buçiti e fuqishme nga gjokset partizane, duke përjetësuar epopenë e lavdishme të tre heronjve. Sa herë që shokët e merrnin këtë këngë, Ahmeti i shoqëronte me mandolinën e tij, të cilën e kishte futur në burg bashkë me një kitarë. Atyre u pëlqente kjo melodi, u pëlqenin edhe fjalët, por për gjendjen në të cilën ndodheshin, duke pasur gjithnjë pranë, pas hekurave, njerëz të shitur te i huaji, i këndonin më me forcë vargjet:

*Milic hor xhubleta,
Shih ku t'çon kuleta,
Parja e huej e shkreta,
Me vra sot vllan tand.*

Këto fjalë demaskuese qëllonin mu në shenjë. Mercenarët tërboheshin. Kështu gardjani Caf Dani dhe të tjerë i kërkuan drejtorisë së burgut që të merrte masa e të ndalonte këtë këngë. Prandaj fashistët e egërsuar u përpoqën të merrnin vesh se kush e kishte nxjerrë këngën. Ata mblodhën të burgosurit dhe, duke u kërcënuar, kërkuan që të tregonin autorin e saj. Por më kot. Asnjëri nuk fliste. Fashistët vazhdonin kërcënimet. Atëhere doli një i burgosur analfabet e tha:

— Unë e di se nuk dal i gjallë prej këndeje. Ç'doni tjetër prej meje? Unë e kam shkruar këngën.

Por drejtori i burgut e dinte se ai nuk mund të ishte autori i këngës, mbasi nuk dinte të këndonte e nuk merrte vesh nga muzika; veç kësaj nuk dinte as të shkruante, prandaj vazhdoi të ngulte këmbë në të vetën.

Atëhere u hodh Ahmet Haxhia e tha:

— Mos e merrni në qafë këtë të shkretë, — dhe tregoi me kokë të burgosurin analfabet. Po ju tregoj të vërtetën. Kangën e kam nxjerrë unë. Kam ndjekë shkollën e mesme dhe i bie mandolinës.

Por fill pas Ahmetit doli një tjetër, e kapi Ahmetin për krahu dhe i tha:

— Pse gënjen? Ti e di mirë që këngën e nxora unë dhe... — Pa e mbaruar ky fjalën u hodh një e thirri:

— Për besë ju gënjejnë, se kangën e kam nxjerrë unë me çifteli...

Kështu Ahmet Haxhia s'e kursente veten e tij, kur ishte fjala për të mbrojtur shokët.

Udhëheqës i pionierëve e i të rinjve

Në pranverën e vitit 1943, në muajin prill, organizata e partisë e qarkorit të rinisë dhe e lagjes Dergut në Shkodër shqyrtoi aktivitetin e këtij djaloshi trim, organizator dhe propagandist të talentuar, i cili edhe kur kish qenë në duart e xhelatëve në burg, kishte qëndruar ballëlartë dhe kishte vazhduar pa asnjë lëkundje punën e nisur, dhe e pranoi njëzëri anëtar të Partisë Komuniste Shqiptare. Dy muaj më vonë u zgjodh anëtar i komitetit qarkor të rinisë, duke u bërë kështu një bashkëluftëtar për kokë i Naimit, Manush Alimanit etj. Në saje të aftësive të tij organizative e të vendosmërisë si komunist, ai fitoi besimin dhe dashurinë e shokëve.



Ahmet Haxhia me shokët e tij të luftës Manush Alimani
(nga e majta) dhe Seit Bushati.

Ahmeti kishte një përvojë të mirë në aktivizimin dhe hedhjen e pionierëve në aksione konkrete. Që në demonstratën e shkurtit të vitit 1942, ai kishte përgatitur pionierët që të ngjitnin parulla në muret e kinemasë, në sallën e së cilës do të shpërthente protesta e të rinjve kundër fashizmit, e cila do të kalonte pastaj në demonstratë, që do të drejtohej nga komunistët.

Ahmeti aktivizoi grupe pionierësh, me anën e të cilëve shpërndante trakte të partisë, siguronte lidhjen e shokëve të njësitit gueril me shokët e çetës, grumbullonte informata mbi agjentët në shërbim të pushtesit, mbi lëvizjet e tyre në ndjekje të shokëve të lëvizjes, organizonte dëmtime autokolonash, furnizimin e partizanëve me veshje, ushqime, municione, kalimin e shokëve nga një bazë në një tjetër, mbledhjen e ndihmave në popull etj. Ngarkimi i pionierëve me këto detyra nga ana e Ahmetit bëhej në mënyrë shumë krijuese; ai mbante parasysht veçoritë e çdo pionieri, moshën, praktikën e punës ilegale, shkathtësinë si dhe provat që kish dhënë secili në kryerjen e detyrave të ndryshme.

* * *

Ahmeti po kthehej në shtëpi. Me vete kishte një pionier të vogël pak zeshkan e flokëkaçurrel, të cilin e kishte marrë në biçikletë përpara. Në rrugë pa se ishte ndalur një kamion me rimorkio, të ngarkuar plot e përplot me bar të thatë. Ai e

shikoi me vëmendje atë kamion, e sytë i nxorën shkëndia. Udhëzoi vogëlushin që kishte me vete se si duhej të vepronte, ndërsa vetë zuri vend në një cep të rrugës, në pozicion mbrojtjeje. Nën xhakëtë mbante në gatishmëri, me gishtin në këmbëz, revolen e tij, që zakonisht e mbante në xhep. Pionieri ju afrua vjedhurazi kamionit e pastaj ndezi një fije shkrepse, me të cilën i vuri zjarrin barit të thatë.

Kur nisi të duket tymi i zi, i cili vinte gjithnjë duke u shtuar, disa ushtarë dolën nga një dyqan frutash aty afër. Flaka që panë i tmerroi. Disa prej tyre bllokuan rrugën. Por Ahmeti me pionierin që kish me vete u largua pa u vënë re, duke kryer me sukses një aksion të rastit.

Ahmeti kishte aftësi të grumbullonte të rinjtë rreth vetes. Në punën edukative me ta ai shquhej si propagandist. Fliste qartë e thjeshtë. Në rrethin e tij të edukimit, ku kishte si dëgjues Shyqri Bushatin, Feta Barbudhushin (që të dy dëshmorë të Luftës nacionalçlirimtare) dhe pesë shokë të tjerë, punonte veprat «Lenini dhe rinia», «Ushtria e Kuqe», «Punëtorët e Bashkimit Sovjetik», «Lenini dhe leninizmi» etj.

Ahmeti nuk ishte vetëm propagandist, por edhe iniciator për tërheqjen dhe aktivizimin e rinisë. Në periferi të lagjes Kiras, në Lamiej, duhe-shin aktivizuar të rinj të varfër, që silleshin atë kohë pa punë. Ahmeti shkoi atje me biçikletë dhe, pasi ju afrua ca djelmohave, nxori një revole të re (Ahmeti ka qenë shumë merakli armësh dhe revolverët shpeshherë i ndërronte) e nisi ta vërtisë në dorë. Të rinjtë ju afruan menjëherë dhe e

rrethuan. Ahmeti nisi të bisedojë me ta, ua dha që ta shikonin edhe armën, të cilën e kaluan dorë më dorë, duke e shikuar me vëmendje. Kur të rinjtë shfaqën dëshirën për të pasur secili nga një armë të tillë që «ta mbanin në xhep», Ahmeti u tha:

— Armë si kjo ka plot dhe mund t'ju tregoj se si t'i gjeni. Por randësi ka për të dijtë përse e mban. Sot vatrën tonë e ka shkelë armiku; ky kërkon të marrë nëpër kambë nderin e Atdheut, të popullit tonë, të qytetit, të familjeve tona. Kundër këtij armiku duhet të marrë zjarr pushka jonë. Ja, për këtë qëllim duhet mbajtur arma e jo për t'u kapardisë para të tjerëve. Tashti mund të thoni se ku të gjeni revole si kjo. Disave edhe mund t'u japim ne komunistët nga ato që ja kemi marrë armikut, po puna ma e mirë do të ishte sikur ju vetë t'ua rrëmbejshit pushtesve ose atyne spiunëve, që sillen poshtë e nalt. — Të rinjtë e kuptuan se ai e kishte fjalën për atë kapterin e xhandarmërisë, që bridhte shpesh në atë anë.

U dogj kuestura

Gjatë periudhës së Luftës nacionalçlirimtare, Ahmeti ishte ngarkuar nga partia, që të mbante lidhje me elementë, që shërbenin në radhët e ushtrisë armike për të siguruar informata të vlefshme për çështje të ndryshme: për të zbuluar agjentët e fshehtë të armikut, për të mësuar se cilët shokë të partisë dhe aktivistë gjurmoheshin, për të mbajtur lidhje me të burgosurit, për t'u siguruar ile-

galëve dokumenta false, për të marrë vesh lëvizjet e forcave fashiste, për të kryer aksione etj.

Shokët e partisë kishin marrë vesh se në kuesturë ruheshin shumë dokumenta që komprometohnin shokë komunistë dhe simpatizues e aktivistë të lëvizjes nacionalçlirimtare. U mendua të kryhej një aksion, të digjej kuestura që kështu të zhduke-shin edhe dokumentat, edhe fashistëve t'u jepej një grusht i rëndë e njëkohësisht të shtohet edhe më shumë fryma luftarake e banorëve të qytetit.

Për kryerjen e këtij aksioni u aktivizua shumë Ahmeti, i cili, nën drejtimin e Vasil Shantos, në bashkëpunim me Hajrullah Kastratin dhe shokë të tjerë, mori masa të gjithanshme.

Ish «rreshteri», i cili i vu flakën kuesturës, tregon:

«I kam kërkue 20 litra benzinë Ahmet Haxhisë për djegjen e kuesturës. Ai dha mendimin për të marrë edhe një bombë 30 kg., që ishte gjetun në fushën e Shtojit. Në ora tre të datës 22.9.43 i dhashë flakë benzinës që kisha hedhë nëpër korridoret e dyert e brendshme të kuesturës. Mbas murit, ku ndodhej kasaforta e kuesturës me dokumenta «jashtëzakonisht sekrete», vuna disa llokume dinamiti dhe i lidha me fitilin e gjatë. Flaka e një çakmaku ndezi fitilin, që çonte zjarrin në kasafortën e kuestorit dhe mandej ju dha flaka korridoreve e dyerve, e cila mbuloi ndërtesën.


Në kulmin e alarmit, kur në të gjitha rrugët e qytetit vraponin si të çakërdisun e të tmerruem reaksionarët e të gjitha kallëpeve, kur kërcisnin zilet e telefonave të kuestorit dhe të njerëzve të tij, që çit-

NDOC DEDA (ANDON DEDA)
(TELI)

«Ju e njihni të gjithë Andon Dedën, dëshmor i popullit, që nuk kurseu jetën, që populli i tij të ketë liri, që populli i tij të ndërtojë jetën më të mirë».

ENVER HOXHA

Në njërën nga kullat e gurta të Milotit, në të vetmen dhomë të madhe sterrë të zezë, ulej pranë dritares së vogël, duke rrëmuar në do fletë li-brash, vocraku i Dedë Markut, Ndoci, i cili për-piqej t'i kryente me kujdes detyrat që jepte mësuesi. Kishte qejf të dëgjonte këngë trimërie, të cilat i shkruante ngadalë-ngadalë, ua jepte shokëve dhe ua mësonte atyre që s'dinin të shkru-anin e të këndonin. Gëzohej Deda kur kthehej nga puna e shikonte se ç'kishte shkruar në fletoret vo-



Ndoc Deda

gëlushi i tij. Vocrraku, kur kthehej nga mali, ku kulloste dhinë, sillte edhe gjëra të reja të shkruara në copa letrash. Ndoci dhe vëllai i tij Gjoka rrinin shpesh kokë më kokë dhe i tregonin njëri-tjetrit se çfarë kishin shkruar. Mbrëmjeve, buzë zjarrit, nën dritën e zbetë të pishës, vocrrakët dëgjonin tregimet e moçme për trimëritë e të parëve që u tregonte babai i dashur. Ishte diçka krejt e rastit ndjekja e shkollës prej Ndocit, mbasi në krejt atë zonë vetëm Miloti kishte një shkollë fillore. Ato katër klasë që mbaroi i krijuan më vonë Ndoc Dedës mundësinë për të punuar si nëpunës në postelegrafën e Milotit. Në atë kohë munda të lidhej me njerëz që kishin pikëpamje përparimtare e deri me komunistë veteranë si me Xhevdet Dodën etj.

Shpeshherë në zyrën e postkomandantit të xhandarmërisë së Milotit bisedohej:

— Ndoc Deda, nëpunës i telegrafës, asht komunist. U ban propagandë të tjerëve kundër nesh.

Habiteshin njerëzit e qeverisë se si ishte e mundur që ai djalosh njëzetvjeçar, që rrallë e tek fliste, të ishte «bolshevik, i kuq». Por të dhënat që merrnin kohë pas kohe i bënë ata që ta kishin nën mbikqyrje, ta ndiqnin deri sa një ditë e pushuan nga puna. Ndoci filloi përsëri të merrej me bujqësi pranë familjes. Ai ishte djalë i qetë, i matur, punëtor dhe i mprehtë dhe këto tipare ja njihnin bashkëfshatarët e tij. Prandaj ata kishin një nderim të veçantë për djalin e Marka-kolajve.

Ndodhte që të mblidheshin burrat e të bisedonin për vrasjen e ndonjë burri, për shkak has-

mërie. Disa ja vinin fajin njërës palë, të tjerë palës tjetër. E në këto raste Ndoci ndërhynte me takt në bisedat e malësorëve e përpiquej t'u shpjegonte se edhe në këtë çështje fajtorë ishin ata që e kishin lënë popullin në padije, që e kishin shitur atdheun te të huajt dhe që në atë kohë ishin vënë në shërbim të pushtuesit. Me fjalën e tij bindëse e të argumentuar bënte për vete dhjetëra burra të moshuar, të cilët dëgjonin me vëmendje. Karakteristikë e bisedave të tij ishin krahasimet që bënte me jetën e gjallë të malësorëve dhe përdorimi i figurave të folklorit, që ishin shumë të goditura e kuptimplote.

Në ushtrinë e vjetër shqiptare

Si shumë moshatarë të tij edhe Ndocin e mobilizuan në ushtrinë e vjetër, për të kryer «detyrimin ushtarak», i cili ishte një shërbim ndaj përandorisë fashiste italiane. Kur ndodhej në Ulqin me shërbim, Ndoc Deda ra në kontakt me shokë komunistë, që punonin për sqarimin e ushtrisë shqiptare, në mënyrë që ajo të dëmtonte pushtuesin dhe të hidhej me armatimet që kish në radhët partizane. Atje u njoh me Naim Gjylbegun, i cili, së bashku me Perlat Rexhepin dhe shokë të tjerë, u interesua për lidhjen e komitetit qarkor të partisë të Shkodrës me shokët, që punonin në ushtrinë e vjetër.

Ndoci nisi të mbajë lidhje e të takohej shpesh me Hajdar Dushin, i cili posa kishte dalë nga burgu dhe ishte futur ilegalisht në repartet ushta-

rake të Ulqinit. Hajdar Dushi, i cili kishte për-
kthyer në Shkodër nga gjuhët e huaja pjesë nga
veprat e klasikëve të marksizëm-leninizmit, or-
ganizoi mjaft biseda me grupet e ushtarëve e në
këtë punë një ndihmë të madhe i dha Ndoci.

Duke qenë i gatshëm të kryejë detyrat e tij
patriotike, Ndoci, me thjeshtësinë që e karakteri-
zonte, me dashurinë dhe vëmendjen që tregonte
për shokët e tij, si njeri i qetë, por masovik, prop-
agandonte mjaft për dezertimin e ushtarëve shqip-
tarë nga ushtria e vjetër, që ishte pjesë përbërë-
se e ushtrisë fashiste.

Duke qenë ndër elementët më të afërt me
shokët, që mbanin lidhje me partinë, ai u muar me
përhapjen e trakteve të partisë në radhët e ush-
trisë. Ato ua shpërndante jo vetëm ushtarëve, por
edhe oficerëve, duke ua futur në libra, në çizme etj.
Bashkë me shokë të tjerë mblidhte materiale për
t'ua dërguar partizanëve, që vepronin në qarkun e
Shkodrës, si ushqime dhe armatime të ndryshme,
që ishin aq të nevojshme për luftëtarët e lirisë.

Me porosi të komitetit qarkor të partisë, në-
përmjet të dërguarve të posaçëm, u organizua de-
zertimi i ushtrisë shqiptare, e cila ishte inkuadruar
në forcat e armatosura të Italisë fashiste. Kështu
natën e 20 korrikut 1943, në orën 22.00, ushtarët
shqiptarë, të vendosur nga porti i Shëngjinit deri
në Tivar, hodhën në det armët që nuk mund t'i
merrnin me vete si topa e predha artilerie dhe u
larguan në drejtim të Shkodrës, duke u ndalur në
Belaj dhe Vukatanë, ku njëri nga shokët drejtues
të lëvizjes së qarkut u foli mbi qëllimet e larta të
luftës partizane. Prej këtej, një pjesë e ushtarëve

kaluan në çetat partizane dhe pjesa tjetër u shpërnda nëpër shtëpitë.

Në njësitet partizane

Në çetën partizane, e cila shpejt u shndërrua në batalionin partizan me emrin e Perlat Rexhepit, u inkuadrua edhe Ndoc Deda, i cili që treguar mjaft aktiv në aksionin që organizoi partia për dezertimin e ushtrisë shqiptare.

Në çetën e tretë të Batalionit «Perlat Rexhepi», Ndoci u takua përsëri me Naim Gjylbegun, u njoh me Ndoc Mazin dhe shokë të tjerë të çetës së tretë.

Një ditë vjeshte të vitit 1943, te murani i Vorfës u bë një mbledhje e zgjeruar e organizatës bazë të partisë të Batalionit «Perlat Rexhepi». Partizanët komunistë diskutonin për pranimin e shokëve të rinj në gjirin e partisë, për shtimin e radhëve të saj me gjak të ri, kryesisht me ata që kishin dhënë prova të shkëlqyeshme se e mbronin me jetën e tyre çështjen e partisë, revolucionin e filluar. Në mes të tyre, i heshtur, por i gëzuar, gjë që e shprehnin sytë plot shkëlqim, ishte edhe skuadërkomandanti i çetës së tretë, Ndoc Deda.

Ndocin e përgëzoi vetë Vasil Shantoja, i cili i shtrëngoi dorën ngrohtësisht dhe e uroi anëtarin e ri të partisë që pushka t'i bëhej top në luftën për çlirimin e vendit.

Ndoci e kremtoi me aksion pranimin e tij në parti. Kur Batalioni «Perlat Rexhepi» u nis për në Krasniqe, shtabi i forcave të Vorfës i ngarkoi Ndo-



Një çetë e batalionit «Perlat Rexhepi». Lart, nga e djathta,
i pari, Ndoc Deda, i treti, Naim Gjylbegu.

cit me njësitin që drejtonte detyrën për të kryer një aksion në rrugën Shkodër-Koplik, në afërsitë e Shtojit. Ndoci, duke aktivizuar me zgjuarësi të gjithë anëtarët e njësitit, organizoi një pritë në rrugën e caktuar, duke e kurorëzuar me sukses aksionin e përgatitur dhe të drejtuar në mënyrë të shkëlqyer. Atje, në atë rrugë, u zunë tre kamionë me mall dhe një veturë gjermane me një spiun brenda, të cilin e përcuellën për në shtab. Këtu Ndoc Deda tregoi aftësi luftarake dhe organizonjëse të një kuadri, që premtonte shumë për të ardhmen.

Pushtonjësit gjermanë dhe veglat e tyre filluan një operacion në vendin, ku ishte krijuar, tre muaj më parë Batalioni «Perlat Rexhepi». Ata mendonin të asgjësonin forcat partizane dhe të terrorizonin popullin e kësaj krahine, që ishte bërë një bazë e rëndësishme e Luftës nacionalçlirimtare. Pushtonjësit gjermanë e filluan operacionin e tyre kundër njësiteve partizane pikërisht në pasdrekën e 12 nëntorit të vitit 1943, kur Batalioni «Perlat Rexhepi» kishte kaluar thellë në malësitë e Tropojës. Edhe në këtë rast, ashtu si kurdoherë, atyre u erdhi në ndihmë kleri dhe krerët e reaksionit. Partizanët ndodheshin të murani i Vorfës, pikërisht në atë vend ku qe pranuar Ndoci në parti, kur erdhën në mënyrë shumë të shpejtë e të maskuar bishat naziste. Edhe në këtë rast Ndoci u tregua luftëtar i rreptë. Në luftim e sipër u shfaqën edhe një herë vendosmëria e tij për të luftuar pa rezerva pushtonjës in dhe veglat e tij, si dhe dashuria e madhe për shokët, të cilëve u mbronte krahët nga sulmi armik, duke ruajtur edhe në be-

tejnë e befasishme gjakftohtësinë, mençurinë dhe trimërinë që e karakterizonte.

Duke kaluar në malësitë e Dukagjinit, të Postribës dhe, më vonë, në malësitë e Vaut të Dejës, në Gomsiqe, Dush e deri në Mnelë e thellë në fshatra të Mirditës me njësitin partizan, Ndoci punoi me malësorët për sqarimin e tyre, demaskimin e reaksionit, që ishte grumbulluar në ato anë, veçanërisht të Gjon Marka Gjonit, të Kolë Bibë Mirakës si dhe të klerit, që ishte vënë plotësisht në shërbim të tyre, të cilët të gjithë së bashku po i shërbenin me besnikëri pushtuesit nazist.

Ndoc Deda dhe shoku i tij i njësitit gjithnjë i qeshuri Ndoc Mazi, mbasi kishin kaluar thellë nga Mirdita, u ndalën për pak ditë në Milot dhe u ranë mes përmes fushave të zymta, plot gardhiqe e moçale, prej nga ngriheshin tufa-tufa mushkonjat që i besdisnin, duke i pickuar orë e çast, ndërsa në brrakat e shpeshta bretkosat këndonin pa mbarim. Ata u takuan me shumë fshatarë, të cilëve u folën për lëvizjen nacionalçlirimtare, për luftën heroike që po bënte populli shqiptar kundër fashistëve e tradhëtarëve. Theksin kryesor e vunë në demaskimin e Bazit të Canit, të cilit në atë kohë i kish hyrë frika në palcë nga që forcat e Divizionit I po afroheshin asaj ane dhe me siguri do t'i qëronin hesapet edhe me këtë tradhëtar. Prandaj ky kishte lëshuar veglat e tij që të mbushte çetat e tij me «nga një burrë për shtëpi». Kështu Ndoc Deda e Ndoc Mazi e penguan këtë tradhëtar që të gënjente fshatarët, shumë prej të cilëve nuk pranuan të futeshin në çetat bashibozuke.

Epopeja e Vigut u shkrua edhe me gjakun e Ndoc Dedës. Ashtu si edhe shokët e tij, ai tregoi vendosmëri për të mbetur për jetë bir i denjë i partisë dhe i popullit, armik i papajtuëshëm i veglave të pushtuesit, të cilëve në kohën e rrethimit ua përplasi në surrat 2-3 letrat «personale» që i dërguan gjoja si një të «njohur», në të cilat i premtounin jetën, pushkën në krah etj. Përgjegjja e tij dhe e shokëve të tjerë qe:

— Këto armë nuk i lëshojmë për deri sa mbi dhe të jenë ende ata që kanë tradhëtue interesat e popullit të Mirditës dhe të gjithë atdheut tonë.

Shtëpia e Dedë Marka Kolës në Milot ishte bërë një bazë e sigurt partizane, e cila u qëndronte burrërisht kërcënimeve të herëpashershme të Bazit të Canit, i cili ishte tërbuar nga që nami i Ndocit kish marrë dhenë në të gjithë vendin për vendosmërinë që kish treguar ky në luftën për çlirimin e vendit dhe nga që ishte hedhur në radhët partizane edhe djali tjetër i Dedës, Gjoka, i cili i printe partizanët atyre shtigjeve dhe më vonë u inkuadrua në Ushtrinë nacionalçlirimtare në Brigadën VI S., gjithnjë si udhërrëfyes e informator.

Mbas rënjes heroike të Ndocit, plaku patriot dhe trim Dedë Marku u lidh edhe më ngushtë me partizanët; ai për çështjen e tyre kishte dhënë trupin e tij, gjakun e tij, Ndocin që e donte aq shumë. Prandaj, kur doli partizan djali tjetër, Gjoka, e porositi që të mos turpërohej, por të luftonte e t'i merrte hak Ndocit dhe shokëve të tij.

Plaku, që ja kishte dhënë të dy djemtë partisë, priste që, mbas kërcënimeve, Bazi i Canit t'i çonte në shtëpi njerëzit e tij që ta arrestonin. Prandaj ai ishte përgatitur që kulla e tij të shndërrohej në një vend, ku do të shkruhej edhe një faqe tjetër e lavdishme në luftën kundër reaksionit.

Mbas çlirimit të vendit, Gjoka, i vëllai i Ndocit, vazhdoi me besnikëri rrugën e nisur, si ushtar besnik e shembullor i partisë, duke kryer detyra të vështira në armën e sigurimit, deri sa u bë edhe komandant vendi në Milot. Nga që ishte bërë një pengesë serioze për reaksionin, diversantët e vranë në pritë.

Poeti, bashkëluftëtar i Gjokës dhe i Ndocit, shkruan për Gjokën:

*«I ri rron prapë ndër kujtime,
N'ato fusha plot gjelbërime,
Ku bie vada në gurgullime,
E s'e mplak as koha as moti,
Gjithnji t'ri e kujton Miloti,
T'ri e kujton Shqipnia mbarë,
Buzës Matës n'lapidar.»*

Busti i Heroit të Popullit Ndoc Deda, i vendosur në mes të Milotit, u kujton gjithë banorëve të asaj krahine, gjithë kalimtarëve, që udhëtojnë për në Shkodër, Pukë, Tropojë, Kukës, në Veri, se Ndoc Deda dhe vepra e tij rrojnë, u tregon lapidari i Gjokës se në ato fusha rron dhe vëllai i tij, luftëtari trim, komunisti Gjok Deda.

HYDAJET LEZHA

(HYDAI)

Lezha, vendi ku lindi dhe u rrit Hydai, siç e quanin të njohurit Hydajetin, ishte në atë kohë një qytet i vogël me pak dyqane kinkalerie, manifakture, me disa artizanë opingarë, teneqexhi samarpunues e qeleshexhi, i rrethuar nga fusha, që përmyteshin në një pjesë të madhe kohe, rrëzë kalasë historike. Të papunë, privatë, matrapazë të ndryshëm silleshin poshtë e përprjetë nëpër Lezhë për të tregëtuar ndonjë send me fshatarët e ardhur për pazar, të cilët ripeshin nga feudalët, kleri e të tjerët. Bujqit e zverdhur nga malarja, e cila bënte kërdrinë, zbrisnin në Lezhë duke kaluar pellgje mbas pellgjesh për të rregulluar një palë opinga apo një enë uji. Për Lezhën e asaj kohe poeti popullor ka shkruar:

*Lezhja ishte vend mjerimi,
Për mushkonja vend banimi,*



Hydajet Lezha

*S'dijti i vorfni çka qe gëzimi.
Kush e kishte në dorë këtu veten,
Ku malarja të merrte jetën?
S'njifej shkolla as ditunia,
Veçse skami e mizoria...*

Në Lezhë ndodhej një shkollë fillore për djem e vajza. Atje kreu disa klasë fillore edhe Hydajeti. I ati, Kasem Kadia, burrë punëtor me të gjitha virtutet e mira, vdiq shpejt dhe e la jetim Hydain. Ndonëse nuk jetoi shumë, ai arriti t'i edukojë të birit ndjenjën e atdhedashurisë së flakët, të cilën ai vetë e kishte treguar që në vitin 1912, me pjesëmarrjen e tij në ngritjen e flamurit në Lezhë.

Hallet e shumta të jetës së vështirë prej jetimi, në atë qendër shumë të prapambetur, e poqën para kohe djaloshin. Hydajeti, duke gjetur mbështetjen te daja i tij i varfër, u mbush shpejt me urrejtje për atë botë të padrejtë që shikonte.

Për të nxjerrë bukën e gojës u bë krahatar në punë të ndryshme, më shpesh si ndihmësmuratori, duke mbajtur llaç e gurë. Shpeshherë, kur nuk gjente fronte pune me muratorë, ose ndonjë tjetër punë krahu, detyrohej të shkonte në Prozhë, me një kmesë në krah, për të prerë dru zjarri, të cilat i shiste në familjet e qytetarëve lezhjanë.

Djaloshi truphedhur, me rroba të vjetëruara, por jo i lëshuar, me kësulën e bardhë në kokë, i binte shpesh mes për mes Lezhës për të gjetur ndonjë punë të çastit. Tek ai u krijua një urrejtje e papërmbajtur klase. Pushtimin e Shqipërisë e priti, ashtu si gjithë populli, me zemë-

rim të thellë. Po ç'të bënte? Që nga ajo ditë Hy-dait ju shtua gjithnjë e më shumë urrejtja jo ve-tëm për përdhunuesin e truallit amtar, por edhe për tregëtarët, feudalët gjakpirës dhe për klerikët, të cilët e pritën fashizmin italian krahëhapur dhe bashkëpunuan me të.

Aktivizimi i Hydajetit në lëvizjen nacionalçli-rintare lidhet me vajtjen në Lezhë të Naimit dhe Ahmetit, si dhe të shokëve të tjerë që shko-nin atje nga Shkodra të ngarkuar nga komiteti qarkor i partisë për aktivizimin e të rinjve dhe të patriotëve lezhjanë në Luftën nacionalçlirim-tare. Në saje të punës së madhe edukative të partisë për ngritjen politike dhe qartësimin ideo-logjik të rinisë, me anë të trakteve, të letërsisë përparimtare apo të rretheve edukative, Hy dai fi-lloi të njohë botën dhe njerëzit. Ndryshe vlerë-sonte tregëtarët, pronarët e mëdhenj të tokave e deri edhe matrapazët, të cilët ua blenin lirë fsha-tarëve hallexhinj shpendët, bylmetrat dhe prodhi-met e tjera, që i shtinin prapë shtrenjt në Shko-dër dhe në Tiranë, krejt ndryshe vlerësonte pu-nëtorët e krahut, ata që rrobtoheshin në qytet e në fshat. Urrejtjen e papërmbajtur ndaj atyre, që shfrytëzonin punën e të tjerëve, filloi t'ua shfaqë njerëzve, me të cilët rrinte e bisedonte apo punonte, rrogëtarëve të çifligjeve të Bregut të Matës apo Zadrimës, me të cilët takohej në Lezhë apo në fshatra.

Ushqimi ideologjik dhe politik që i jepnin komunistët me anë të komunikatave, bisedave mbi gjendjen e vendit, mbi Luftën nacionalçlirimtare, e bënë tjetër njeri Hydajetin: nga një punëtor

që sillej nëpër Lezhë për të bërë ndonjë punë krahu, i cili s'kuptonte asgjë përtej asaj qendre të vogël, ai u kthye në një të revoltuar, që kish gjetur rrugën e luftës kundër atyre, që shtypnin popullin dhe atë vetë, në një ushtar aktiv të kryengritjes së madhe të armatosur që po udhëhiqte Partia Komuniste Shqiptare.

Një ish-pjesëmarrës në lëvizjen nacionalçlirimtare ka shkruar për Hydain:

«...Jam takue disa herë me këtë djalosh sypatrembun, i cili qysh në ditët e para të lëvizjes nacionalçlirimtare u hodh me të gjitha energjitë e tij djaloshare për të përhapë fjalën e partisë në popull, për të shpërnda trakte dhe komunikata, për të mbledhë ndihma dhe armë për partizanët. Kur u pranue në radhët e Rinisë Komuniste Shqiptare, i shumëfishoi fuqitë e tij dhe me një guxim të pashe-mbullt zbatonte me vetëmohim detyrat që i ngarkonte partia. Sa herë më kish folë për ditët e bardha që do të vinin me çlirimin e Atdheut. Ai andërronte për një Shqipëri të lirë e pa shfrytëzues, sepse e kish provue në kurrizin e vet shfrytëzimin e vorfninë».

Megjithëse ra në sy të autoriteteve, për aktivitetin që kishte filluar, ai nuk trembej, por përpiqej me çdo mënyrë që t'i shërbente lëvizjes, partisë, popullit.

Në pamundësi për të qëndruar në Lezhë, Hy-

dajeti u inkuadrua në njësitin e përjetësuar «Një-
siti i Vigut». Atje, siç thonë vargjet,

*Hydajeti djal' lezhjanë,
Rritë jetim pa bab', pa nanë,
Strehve t'huej flej pa ngranë,
Mori malin për të letë,
Babë e nanë i gjeti n'çetë,
Vlla e motër nga çdo anë
Gjet ndër shokët partizanë.*

Së bashku me shokët e tjerë kaloi fshatrave të Mirditës dhe të malësisë së Lezhës për të kryer misionin, të cilin ja kishte ngarkuar partia njësitit të vogël partizan.

Në çastet e vështira të rrethimit, në përleshjen me mercenarët e Gjon Marka Gjoni, bashkë me shokët e tij edhe Hydajeti shkroi me gjakun e tij epopenë e Vigut. Poeti shkruan për çastet e fundit të jetës së tij:

*«Hydajet, o Hydajet,
Pushka jote drejt po qet.
« — Qilloi vendi rrahë-shkret,
Pa një stom e ,a një shkrep,
Kurrë nuk binja kaqë shpejt».*

Kështu, Hydai vaditi tokën e zallit të Vigut me gjakun e tij, duke rënë me armë në dorë në tokën e mëmëdheut tonë, duke u bashkuar me mijëra të tjerë, që, si ai, kishin flijuar e po flijonin jetën e tyre të re për një Shqipëri të lirë, të kuqe,

Ashtu si shokët e tij, për aktin e lartë heroik, Hydajeti është dekoruar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor me titullin më të lartë, atë të Heroit të Popullit dhe me Medaljet e Trimërisë, të Kujtimit dhe të Çlirimit. Busti i tij, emri që mban shkolla 12-vjeare në Lezhë, këngët e rapsodëve dhe të poetëve tanë e kanë përjetësuar aktin e tij heroik të kryer për fitoren e revolucionit tonë.

PERMBAJTJA

	Faqe
Epopeja e lavdishme e Vigut	3
Ndoc Mazi (Minuku)	27
Naim Gjylbegu (Besniku)	49
Ahmet Haxhia (Tigri)	67
Ndoc Deda (Andon Deda) (Teli)	84
Hydajet Lezha (Hydai)	95

50711

**MIHALKA E SHITET
GJERANISHT**

Tirazhi 8000 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-65

Shtyp NISH Shtypshkronjave «MIHAL DURI»

Stabilimenti «8 NËNTORI» — Tiranë, 1969